

1 E martë, 21 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes. Mirë se erdhët.

7 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Po shoh në të djathtë. Kush është i pranishëm nga ZPS-ja?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithë brenda
15 dhe jashtë sallës së gjyqit. Prokuroria ka përfaqësues Gaia
16 Pergolo, ndihmësprokurore, Line Pedersen, që është menaxhere e
17 lëndës, Federica Genovesi, që është stazhiere edhe unë, Cezary
18 Michalczuk, Prokuror.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Mbrojtësi i Viktimave, fjala është për ju.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Unë jam Simon Laws, Avokati i
23 Viktimave në këtë çështje gjyqësore.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Në të majtë, Ekipi i Mbrojtjes.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Mirëmëngjesi. Jemi me z. Shala
2 këtu. Unë jam Jean-Louis Gilissen. Hedi Aouini, Leto Cariolou,
3 Dzeneta Petrovica, Juliette Healy dhe Judit Kolbe.
4 Faleminderit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Mirëmëngjes, z. Shala. A më thoni më dëgjoni mirë?

8 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju dëgjoj
9 shumë mirë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Do vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 03887, z. Zijadin
13 Hoxha, i cili do të japë dëshmi në seancë publike.

14 A ka ndonjë gjë që palët apo Mbrojtësi i Viktimave duan
15 të parashtrojnë në këto momente?

16 Prokuror?

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

18 Dua t'i kërkoj leje Trupit Gjykses që të shtojmë në
19 listën e prezantimeve për kundërpjetjet dy materiale, janë dy
20 pjesë video të intervistave që ka dhënë z. Zijadin Hoxha.
21 Pjesa 1 dhe Pjesa 2, nga dhjetë sekonda, pak a shumë, secila.

22 Arsyeja për kërkesën e vonuar është se dje z. Hoxha
23 përmendi disa data që nuk u korrespondojnë datave që ka thënë
24 në intervistën me ZPS-në. Prandaj ne duam t'i tregojmë videon
25 dhe t'i bëjmë disa pyetje lidhur me datat.

1 Po ashtu besojmë që kjo nuk cenon Mbrojtjen sepse videot
2 e intervistës së z. Hoxha janë nxjerrë Ekipeve të Mbrojtjes në
3 format të redaktuar në tërësinë e vet më 9 nëntor të këtij
4 viti. Faleminderit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit, z. Prokuror.

7 Mbrojtësi i Viktimave, a keni ndonjë parashtrim?

8 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Mbrojtës.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ne nuk e dimë se për cilën pjesë
12 të videos bëhet fjalë. Po ne këtu jemi të gjithë të interesuar
13 të zbulojmë të vërtetën, kështu që nuk kam asnjë kundërshtim.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
15 për t'ju përgjigjur pyetjes suaj, mesa kuptova unë, është
16 diçka lidhur me datat. Diskutuar dje shkurtimisht nëse ka qenë
17 prilli apo maji me dëshmitarin, kjo ka qenë paqartësia.

18 Shoh që Prokurori po pohon me kokë.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, për këtë bëhet fjalë. Kjo
20 paqartësia me datat, kur ka shkuar z. Hoxha në uzinën në Kukës
21 dhe ne duam t'i tregojmë disa pjesë të intervistës me video.

22 Materialet që do t'u shtojmë ne në listën tonë të
23 prezantimeve, për procesverbal, është materiali 077857B Pjesa
24 1, një pjesë e kësaj. Materiali i dytë është 077857B Pjesa 2,
25 edhe këtu një pjesë të videos do t'i tregojmë. Kjo është

1 paketa, me sa më kujtohet mua, ju thatë që është paketa e
2 materialeve 12.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
4 Do të vendosim më vonë në lidhje me këtë por e kemi shënim.

5 Ka ndonjë gjë tjetër që doni të parashtroni?

6 Në rregull.

7 Vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 03887. Mbrojtës, ju
8 kujtoj dhe një herë që duhet të bëni pyetje të hapura. Sa i
9 takon kohës që ju ka mbetur, vërej që keni përdorur tre orë e
10 një çerek dhe dje na informuat që mendoni që ju nevojitet dhe
11 rreth një orë. E marrim parasysh kërkesën tuaj. Edhe do të
12 sjellim dëshmitarin në sallë.

13 Shoh që kolegu juaj është çuar në këmbë.

14 Fjala është për ju.

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, thjesht një aspekt
16 administrativ. Dhe ne kemi çuar një email për të kërkuar që të
17 shtohen disa materiale shtesë dhe këtë e kemi bërë konform
18 udhëzimit që keni dhënë ju dje.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
20 marrë parasysh këtë gjë dhe do ta diskutojmë pasi të kemi
21 pasur mundësinë, tetë segmentet e videove që doni të përdorni.
22 Do ta diskutojmë edhe këtë. Faleminderit.

23 Në rregull. Tani dëshmitarin mund ta sillni në sallë.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

1 se erdhët Dëshmitar. A më dëgjoni?

2 DËSHMITARI: Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

4 Shala, ju e dëgjoni Dëshmitarin?

5 DËSHMITARI: Po, e ndëgjoj shumë mirë.

6 Mirëmëngjes.

7 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Dëshmitar, si jeni?

10 DËSHMITARI: Mirë. Ju faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Dëshmitar, ju kujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
13 vërtetën. E kuptoni këtë?

14 DËSHMITARI: Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
16 mirë.

17 Avokat, ju jap fjalën të vazhdoni me pyetjet tuaja.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

19 DËSHMITARI: W03887 [Vijon]

20 Pyetje nga z. Gilissen: [Vazhdim]

21 Z. GILISSEN: [Përkthim]

22 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

23 PË. Mirëmëngjesi.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar

25 Gjykatës, do t'i lutesha Sekretares të Gjykatës, të vendoste

1 në ekran jo segmentin e parë që kemi kërkuar. Mund ta kalojmë
2 këtë pjesë se ishte thjesht për të treguar vazhdimësinë në
3 videon tjetër. Segmenti i parë i videos që kishim kërkuar më
4 minutën 2 sekonda 7, nuk na nevojitet më.

5 Por mund të shkojmë në një pjesë tjetër të videos që
6 është me numër ERN 078252-01 dhe kemi nevojë të shohim nga
7 sekonda e 8 deri në minutën 2 sekonda 30.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
9 shoh. Nga sekonda e 8 po thoni? Deri në minutën 2 sekonda 30.
10 Sekretare, vazhdoni.

11 Në parashtrim e protokolluar kishit kërkuar një segment
12 më të gjatë dhe ju falënderoj që e keni shkurtuar pak për hir
13 të kohës.

14 [Luhet videoincizimi]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Gilissen, fjala është për ju.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Dëshmitar, a e keni incizuar ju këtë video?

19 PË. Po.

20 PY. Kur? Kur e keni incizuar këtë pjesë të videos?

21 PË. Ky incizim është i incizu më 2 qershor 1999.

22 PY. Ku? Ku e keni incizuar?

23 PË. Faktikisht në zyrën e Latif Fejzullahit. Unë mbrena në
24 uzinë.

25 PY. A është një --

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

2 keni bërë pyetjen tani.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim]

4 PY. Ishte vendi, pra, ku flinit?

5 PË. Po. Kjo dhomë ka qenë faktikisht që ju kam tregu më

6 përpara që kam flejtë edhe unë në këtë dhomë. Kanë qenë tre

7 shtretëni, a kemi flejtë katër vetë.

8 PY. Do doja të më thoni, a ka qenë dhomë e vogël, si mund ta

9 përshkruani këtë dhomën? Ne e pamë pak, po nuk e pamë të plotë
10 dhomën. Do doja të më tregonit pak për ambientin atje.

11 PË. Po është përafërsisht dikun ka 9 metra, 10 metra katror,
12 nuk është më e madhe.

13 PY. Faleminderit. Çfarë po shohim në këtë video? Çfarë po
14 ndodh aty? Çfarë kishte? Çfarë ngjarje ishte ajo që po
15 incizonit ju?

16 PË. Po kjo faktikisht ka qenë pas një ditë të lodhshme e të
17 mërzitshme, varrimi i dëshmorit Abdurrahman Gardellaj. Në
18 mbrëmje, rastësisht, jemi taku këtu faktikisht edhe kemi ndejt
19 si shoqni. Edhe thotë një fjalë popullore e jona shqiptare,
20 trimat nuk vajtohen, po këndohen.

21 PY. A ishte e zakonshme për ju që të takoheshit e të këndonit
22 gjatë mbrëmjeve?

23 PË. Jo. Kjo ka qenë hera e parë dhe e fundit.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për qëllimin e identifikimit të

1 personave që shohim në këtë video do të doja që të shihnim
2 disa imazhe.

3 Ju lutem a mund të shohim imazhin në sekondën e 17.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Vazhdoni, Sekretare.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Dëshmitar, kush është personi në të majtë?

8 PË. Personi në të majtë është Latif Fejzullahi.

9 PY. Faleminderit. Po personi në mes?

10 PË. Është Shefki Avdullahi.

11 PY. Po personi i tretë kush është?

12 PË. Është Ismet Thaçi.

13 PY. A e dinit të cilit njësit ishin këta tre persona?

14 PË. Faktikisht ça jemi aty jemi të logjistikës.

15 PY. Shumë faleminderit.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shohim ju lutem imazhin në
17 sekondën e 30.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Vazhdoni , Sekretare.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim]

21 PY. Këtu shohim një grua, një vajzë, mbase dhe dy. Duhet të
22 na thoni ju. A mund të na shpjegoni kush janë personat që po
23 shohim në ekran?

24 PË. Këto kanë qenë të sanitetit faktikisht, po emrat nuk jua
25 di.

1 PY. A kishin ndonjë gjë të veçantë në uniforma, a kishin
2 ndonjë gjë të veçantë në uniforma ato që njerëzit ta kuptonin
3 që ishin të sanitetit, ndonjë shenjë dalluese?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
5 mund ta sqaroni çfarë është kjo "sanitet", çfarë është
6 "sanitet"? Nuk e kam të qartë çfarë është "saniteti".

7 Z. GILISSEN: [Përkthim]

8 PY. A mund të na e shpjegoni Dëshmitar, çfarë është saniteti?

9 PË. Faktikisht janë motrat medicinale që ua kanë dhënë
10 ndihmën e parë ushtarëve kush ka pasë nevojë mbrena uzinës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A,
12 pra, ishin personel mjekësor?

13 DËSHMITARI: Po.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kështu e kuptova dhe unë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit.

18 PY. Sipas jush dhe, sigurisht nëse e dini, mos hamendësoni,
19 këto motra a kishin ndonjë gjë të veçantë, dalluese që të
20 kuptohej që ishin motra apo që ishin ndihmëset mjekësore?

21 PË. Po kohën faktikisht kur nuk kam pasë nevojë për me
22 intervenu dikund atëherë kanë mbajtur kështu uniformat,
23 përndryshe i kanë pasë mantilat e bardhë dhe asgjë tjetër
24 diçka me u identifikuar ma shumë.

25 PY. Faleminderit.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të shohim imazhin në
2 sekondën e 48?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Vendoseni, ju lutem, në ekran.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, kush është personi në këmbë me bluzë të
7 gjelbër?

8 PË. Ky a Xhemshit Qerimi.

9 PY. A e dini nga cili njësit vinte?

10 PË. Po faktikisht na të gjithë që jem këtu, jemi të
11 logjistikës jemi.

12 PY. Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Avokat, më falni që ju ndërpreva.

15 Kam unë një pyetje për motrat medicinale. Uniforma që
16 mbanin veshur, uniforma ushtarake, ju thatë se mbanin
17 uniforma. Uniformat e tyre dallonin nga uniformat e tjera të
18 ushtarakëve në bazë?

19 DËSHMITARI: Jo, nuk kanë pasë kurrfarë dallimi nuk kanë
20 pasë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
22 rregull. Faleminderit.

23 Faleminderit, Avokat. Fjala është sërish për ju.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

25 A mund të shohim imazhin në minutën 1 në sekondën 1.

1 PY. Dëshmitar, kush është ky personi me mjekër dhe me bluzë
2 të zezë?

3 PË. Ky është Bedri Azemi.

4 PY. Faleminderit.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit dhe Sekretares.

6 Kam dhe një pyetje tjetër.

7 PY. Në cilin kat, në cilin nivel ishte kjo dhoma në ndërtesë?

8 PË. Ka qenë kati përdhes.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mund të shohim një segment
11 tjetër. Dua të shohim tani videon që mban numrin ERN 078252-01
12 dhe të shohim minutën e dytë, nga minuta 2 sekonda 30 deri në
13 minutën 3, minutën e tretë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Avokat, përpara se të bëjmë këtë dua të bëj dhe një pyetje
16 tjetër shtesë.

17 Ju thatë "kati përdhes". Kati përdhes i cilës prej
18 ndërtesave?

19 DËSHMITARI: Faktikisht në ndërtesën qendrore që ka qenë
20 komanda. Ku ka qenë komanda e logjistikës, kati predhës.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
22 diskutuam dje. E qartë. Faleminderit.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Sekretare, vazhdoni.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Transkripti është me ERN 078252-
2 01-TR-ET për anglishten në faqen 1, ndërsa shqipja me ERN
3 078252-01-TR-AT, në faqen 1.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
5 Do vendosim në ekran vetëm versionin në gjuhën shqipe, juve,
6 Avokat, doni që të ketë edhe zë? Për çfarë po kërkon
7 transkriptin?

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, thjesht për të identifikuar
9 personin që po flet.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse
11 nuk mund të vendosim tre imazhe në ekran. Vetëm dy imazhe mund
12 të vendosim në ekran. Ju kërkuat dhe anglishten. Nuk e kam të
13 qartë.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk është nevoja për zë jo.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
16 atëherë pse po kërkon që të vendoset transkripti në gjuhën
17 shqipe?

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ishte thjesht për informacion për
19 procesverbal.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
21 atëherë po shohim vetëm videon. Mund ta hiqini transkriptin
22 Sekretare. Faleminderit.

23 Avokat, mund ta shohim videon tani. Po kur duhet ta
24 ndalojmë, në cilin minutazh? Mbase e thatë po nuk e mbaj mend.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]. Vetëm

1 dhjetë sekonda më mjaftojnë. Thjeshtë për të identifikuar
2 personin.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
4 rregull. Kaq më nevojitej dhe mua.

5 Sekretare, ju lutem luani videon për dhjetë sekonda.

6 [Luhet videoincizimi]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Avokat, fjala është për ju.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po.

11 PY. Dëshmitar, a mund ta identifikoni personi që është pas
12 burrit që është ulur në tavolinë?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kush?

14 Avokat, cilin person duhet të identifikojë?

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Personi që shohim në ekran.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ah,
17 personin që është me shpinë po thoni? Shpinën e kujt po shohim
18 këtu?

19 DËSHMITARI: Faktikisht jam unë.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim]

21 PY. Faleminderit.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mund të shohim një fragment
23 tjetër. E njëjta video, po më duhet minuta 6, sekonda 9, deri
24 në minuta 6, sekonda 9 deri tek minuta 6, sekonda e 46.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Luajeni këtë pjesë, Sekretare.

2 [Luhet videoincizimi]

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për qëllim identifikimi, a mund
4 të ndaloni tek minuta 6, sekonda 9.

5 PY. Dëshmitar, a mund të na e thoni emrin e personit që
6 shohim në ekran?

7 PË. Ky është një ushtar që ka ardhë prej Amerikës me Brigadën
8 Atlantike për çlirimin e Kosovës. Shefki e ka pasë emrin.
9 Mbiemrin nuk e di.

10 PY. E keni parë, e shihnit shpesh në uzinën e metalit në
11 Kukës?

12 PË. Jo, atë natë ka ndejt. Rastësisht na kanë dëgju tuj këndu
13 në atë dhomë edhe kanë ardhë si mysafirë.

14 PY. Faleminderit.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të shohim imazhin në
16 minutën 6 sekonda 22.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Vendoseni, Sekretare.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, kush është personi me bluzë të zezë, me beretë
21 të zezë që shohim në ekran?

22 PË. Ky është Muhamet Kuka. Dhe ky ka ardhë prej Amerike
23 faktikisht me Brigadën Atlantike.

24 PY. Faleminderit shumë. Atëhere kjo fotografia, z. Dëshmitar,
25 është bërë në të njëjtën dhomë aty ku ishin ato përpara si dhe

1 ushtarëve të tjerë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ku
3 është bë kjo fotografi? Është më e lehtë. Ku është bërë kjo
4 fotografi?

5 DËSHMITARI: Të gjitha këto fotografi janë bë në të
6 njëjtën ambient faktikisht, në të njëjtën dhomë.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim]

8 PY. Faleminderit shumë.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëhere mund të kalojmë tek një
10 pjesë tjetër. E njëjta video dhe bëhet fjalë për pjesën nga
11 minuti i 17, 45 sekonda, deri në minutin 17, 50 sekonda.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
13 Sekretare, ju lutem nxirreni në ekran.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim]

15 PY. Z. Dëshmitar, e njihni kush është ky person?

16 PË. Është Shefki Avdullai

17 PY. Faleminderit. E keni filmuar ju këtë, xhiruar ju këtë
18 pjesë të videos?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Kërkoj ndjesë, z. Avokat. Për kë po flasim këtu?

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po flasim për personin që është
22 përballë nesh. Përpara imazhit që kemi ndaluar këtu, ky është
23 një mashkull në rrugë e pamë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
25 mund ta shikojmë edhe një herë pjesën e videos sepse nuk e

1 pashë.

2 Znj. Sekretare, ju lutem shfaqeni dhe një herë.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për këtë bëhet fjalë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Mund të vazhdoni.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Më duket se dëshmitari besoj ka
8 ngritur dorën.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Dëshmitar, keni fjalën juve.

11 DËSHMITARI: Më falni. E gabova emrin është Fadil Hoxha,
12 jo Shefki Avdullai. Është Fadil Hoxha është.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 rregull, z. Dëshmitar.

15 DËSHMITARI: E ngatërrova emrin. Më fal.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 S'është problem. E konstatuam atë që thatë tani.

18 Z. Avokat Mbrojtës, e keni fjalën përsëri juve.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

20 Mund të kalojmë tek pjesa e fundit e videos. Nga minuti
21 17:52 sekonda deri në 18:36 sekonda.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
23 Sekretare, ju lutem shfaqni në ekran videon e kërkuar.

24 [Luhet videoincizimi]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim]

3 PY. Z. Dëshmitar, në cilin njësit apo brigadë ishte ky
4 ushtar?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Kërkoj ndjesë që po ju ndërpres, z. Avokat. Po të fillojmë
7 ndoshta me rregullën me pyetjet e zakonshme kur dhe ku.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar. Kërkoj
9 ndjesë, sot po i ngatërroj të gjitha.

10 Në fillim të videos, shohim një ushtar, do të doja të di
11 nëse dëshmitari është në gjendje të identifikojë njësinë apo
12 brigadën.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Ndoshta nuk isha e qartë. Unë do të doja që fillimisht të
15 pyesni kush e filmojë, kush e xhirojë këtë, ku dhe kur.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Si zakonisht. E kuptoj.

17 PY. Z. Dëshmitar, e keni xhiruar ju këtë pjesë të videos që
18 sapo pamë?

19 PË. Po, unë e kam xhiru.

20 PË. Në rregull. Kur e keni e xhiruar këtë pjesë të videos që
21 pamë?

22 PË. Ky xhirim është bërë më 4 qershor 1999.

23 PY. A ka diçka në këtë video që ju jep juve informacion që të
24 jeni të sigurt për datën e xhiritit?

25 PË. Po jam i sigurt se faktikisht më 4 qershor është varrosë

1 dëshmori i kombit Gani Saramati.

2 PY. A ka ndonjë detali aty që ky varrim është bë në këtë
3 ditë?

4 PË. Më falni, nuk ju kuptova.

5 PY. Duhet të jem i sigurt për datën, ju sapo thatë që ishte
6 varrimi i një personi të caktuar që ju përmendët, tani a ka
7 ndonjë detal këtu që ju bën juve të jeni të sigurt për këtë
8 datë dhe nuk bëhet fjalë për një datë tjetër?

9 PË. Po është data e sigurt se faktikisht datat e dëshmorëve
10 kur janë varros dihen. Ato janë shkru në histori.

11 PY. Në rregull. Pamë disa ushtarë, pyetja ime tani është në
12 cilën njësi ishin këta ushtarë apo brigadë këta ushtarët që
13 janë afër furgonit aty.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Përpara se të shkojmë më tej, do të doja të di ku është
16 xhiruar kjo gjë?

17 Z. GILISSEN: [Përkthim]

18 PY. Ku e keni xhiruar këtë pjesë?

19 PË. Për momentin fotografia ku është janë varrezat e Kukësit.
20 Konkretisht janë bash varrezat.

21 PY. Tani shohim këta ushtarë dhe këtë furgonin në rrugë, këtë
22 kombin, ku ishte kjo rrugë në cilin vend?

23 PË. Kjo a mbrena varrezave. Këtu ku është kjo fotografi
24 faktikisht që e shoh unë tani për momentin, është mbrena
25 varrezave të Kukësit.

1 PY. Faleminderit shumë. Tani pyetja cilës njësi apo brigadë i
2 përkisnin këta ushtarë që janë afër kombit këtu?

3 PË. Nuk e di faktikisht. Një pjesë është e logjistikës. Se në
4 rastet konkrete kur kemi pasë ndonjë varrim apo diçka tjetër
5 komplet ushtarët e logjistikës janë angazhu në atë aspekt. Po
6 ka pasë edhe ushtarë të brigadave të tjera faktikisht që na u
7 kanë bashkangjitë. Na u kanë bashkangjitë edhe qytetarët. Këtu
8 janë përmbi 1.000 vetë që kanë marrë pjesë në kët varrim.

9 PY. Në rregull. Faleminderit shumë.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Përfunduar me këtë video. Mund të
11 kalojmë te video numër 6, ERN 075138-03. Dua të shfaqim në
12 ekran pjesën e parë nga fillimi në sekondën 6.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
14 Ta shoh pak. Edhe ky xhirim, është filmim, xhirimi i varrimit
15 të Gani Saramatit, a është e njëjta gjë? Fugoni blu dhe
16 ushtarët e tjerë.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ideja është që të sigurohemi për
18 datën. Kemi ca hollësi ca detaje por duhet të kemi konfirmim
19 të datës. I vetmi qëllim i kësaj është kjo pra që të
20 konfirmojmë datën.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] në
22 rregull. E kuptova.

23 Znj. Sekretare, shfaqeni dokumentin e kërkuar në ekran ju
24 lutem?

25 [Luhet vidioincizimi]

1 Z. GILISSEN: [Përkthim]

2 PY. Nga kjo që pamë a jeni në gjendje të na thoni në cilën
3 datë është xhiruar, është bë ky xhirim, pra, është filmuar kjo
4 pjesë?

5 PË. Po ju thashë, është 4 qershori 1999.

6 PY. Dhe ju e keni bë këtë xhirim?

7 PË. Po, unë e kam xhirue.

8 PY. Faleminderit shumë.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mund të kalojmë tek një pjesë
10 tjetër. Nga sekondi 15 deri tek sekondi 44.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
12 Sekretare, ju lutem shfaqni videon në ekran.

13 [Luhet videoincizimi]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. A e keni xhiruar ju këtë video, z. Dëshmitar?

18 PË. Po, unë e kam xhiru.

19 PY. Kur dhe ku e keni xhiru këtë?

20 PË. Faktikisht më 4 qershor 1999, në varrezat e Kukësit.

21 PY. A mund të na jepni një përshkrim dhe shpjegim të asaj që
22 pamë?

23 PË. Po faktikisht është parapërgatitje për varrimin e
24 dëshmorit. Tjetër shpjegim s'po di çka me dhanë.

25 PY. A keni parë sa arkivole ishin, apo numrin e arkivolit?

1 PË. Kët ditë veç një, vetëm Gani Saramati është.

2 PY. Në rregull. Faleminderit.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Të kalojmë tek një pjesë tjetër
4 tani nga 1 minutë, 12 sekonda deri 2 minutë e 51 sekonda.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
6 Sekretare, ju lutem shfaqni pjesën e kërkuar në ekran.

7 [Luhet videoincizimi]

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për këtë do të doja të kishim
9 edhe zërin tek faqja përkatëse e transkriptit është 075138-03-
10 TR-ET për versionin në anglisht.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Neve
12 na duhet versioni në shqip pastaj do bëhet përkthimi në
13 anglisht. Përpara se të shkonim, përse ju duhet kjo, zëri pse
14 ju duhet?

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Sepse në këtë pjesë të videos
16 kemi një fjalim dhe qëllimi është që ta përfshinim edhe këtë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
18 duhet të kemi një arsye të fortë konkrete. Përpara ishte
19 çështja e datës dhe e kuptoj këtë, ajo që doni të vërtetonit
20 pra, datën saktësinë e datës. Tani të dëgjojmë 3 minuta e
21 gjysëm fjalim mortor, nuk më duket e arsyeshme.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kur të marrë informacionin e
23 duhur që është për identifikimin e personit që është varrosur,
24 do të ndaloj vetë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

1 ju nuk e dini saktësisht kur është?

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në fillim.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
4 këtë ta dëgjojmë njëherë.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dokumenti i transkriptit në
6 versionin në shqip është 075138-03-TR-ET.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ssepse
8 këtu thatë që është pjesa që kërkonit të shfaqnit ishte duke
9 filluar nga minuti 1 e 12 sekonda.

10 Mund të vazhdoni.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ndoshta përkthyesit mund të na
12 japin informacion me emrin e personit që është varrosur.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 qoftë se ka zë, përmbajtje, do të përkthehet nga përkthyesit
15 në kabina.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

17 [Luhet Videoincizimi]

18 PËRKTHYESI: [Zëri] "Në njësitet e ushtrisë çlirimtare të
19 Kosovës, në varrezat e qytetit të Kukësit për t'ia bërë
20 nderimet luftëtarit të lirisë kombëtare shqiptare, ushtarit të
21 dalluar Gani Hamdi Saramatit, i cili heroikisht dhe u përball
22 me hordhitë çetnike serbe në vijën e parë të frontit në tokën
23 e Hasit të Kosovës në Plane e në Mazrek".

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit. Kërkoj ndjesë zonja përkthyesë se e ndërpreva

1 ndërsa po përkthenit.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

3 PY. Z. Dëshmitar, a jeni në gjendje tani ta konfirmoni që
4 bëhet fjalë për varrimin -- që varrimi i z. Gani Saramati
5 është bërë në ditën që përmendët, na dhatë më herët?

6 PË. Po ajo është e vërteta.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
8 keni xhiruar ju këtë pjesë? Apo ta bëjmë pyetje të hapur. Kush
9 e ka xhiruar këtë pjesë?

10 DËSHMITARI: Unë e kam xhiru. Të gjithë këto xhirime i kam
11 xhiru unë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
13 neve duhet ta bëjmë këtë pyetje çdo herë që shfaqet diçka. Kjo
14 është arsyeja përse ne bëjmë të njëjtën pyetje në mënyrë të
15 përsëritur.

16 Z. Avokat, e keni fjalën juve.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim]

18 PY. Kam një pjesë të fundit. Nuk kam pyetje lidhur me vetë
19 materialin, por duhet thjesht të sigurohemi që është pjesë e
20 filmuar nga dëshmitari, sepse pjesa vijuese e kasetës ka të
21 bëjë me diçka që ka ndodhur në Gjermani që lidhet me këtë
22 rast. Dhe thjesht dua të marr nga dëshmitarin konfirmimin,
23 pra, që të më konfirmojë që kjo është pjesa e fundit e kasetës
24 lidhur me praninë e tij në Shqipëri.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Bëhet

1 fjalë për 4 më duket.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 vazhdoni, znj. Sekretare.

5 [Luhet videoincizimi]

6 Z. GILISSEN: [Përkthim]

7 PY. Z. Dëshmitar, e keni xhiruar ju këtë video?

8 PË. Po.

9 PY. Kur dhe ku e keni bë këto xhirime?

10 PË. Tash për momentin nuk posh asgjë. I pashë vetëm varrezat
11 i pashë. Asgjë tjetër nuk pashë.

12 PY. Sipas jush, a ju kujtohet, a është kjo skena e fundit që
13 keni xhiruar në Shqipëri?

14 PË. Po faktikisht është skena e fundit e incizume në
15 Shqipëri. Më nuk kam incizu.

16 PY. Faleminderit shumë. Përfunduar me videon.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

18 Dëshmitar, pjesa që sapo pamë, 4 sekonda, a është kjo pjesa e
19 fundit e materialit që është filmu në këtë kamerë për këtë
20 periudhë kohore?

21 PË. Po, kjo është fundi. Më nuk s'kam incizu me atë kamerë
22 më.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull. Sepse nuk e kam shumë të qartë, se fillimisht ju bë
25 pyetja juve ku e filmuat këtë pjesë të fundit dhe përgjigja

1 juaj ishte "Unë vetëm pashë varrezat, s'pashë asgjë tjetër".

2 Pra, pyetja ime është nga e dini ju që kjo është gjëja e
3 fundit që keni incizu?

4 DËSHMITARI: Po e di faktikisht se herën e fundit varrimi
5 i fundit e kam incizu të gjitha varrezat që kanë qenë
6 faktikisht pesë dëshmorët e kombit që i kemi varrosë. Janë të
7 gjitha varret janë ren.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull. Na dhatë pak më shumë hollësi këtu. Përgjigja është
10 me e qartë. Faleminderit.

11 Z. Avokat, vazhdoni.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, mbas këtyre varrimeve ku shkuat ju?

14 PË. Po faktikisht jemi kthy, unë te uzina jemi kthye.

15 PY. Sa kohë mbas këtij filmimi jeni largu nga Kukësi?

16 PË. Nuk e di saktësisht, po dikun me 6 ose 7 qershor jam
17 largu me urdhën të komandantit. Kam shku për Gjermani.

18 PY. Në rregull. Faleminderit.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Tani besoj që mund të kalojmë në
20 seancë private.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
22 fakt do të veprojmë ndryshe.

23 Znj. Punonjëse, a mund ta shoqëroni dëshmitarin jashtë
24 për një çast.

25 Z. Dëshmitar, ne e kemi debate që do t'i bëjmë këtu

1 pastaj ju thërrasim prapë, ju sjellim prapë brenda.

2 Faleminderit.

3 DËSHMITARI: Në rregull. Faleminderit.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit. Tani mund të kalojmë në seancë private.

7 Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private ju lutem.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit. Mund ta sillni sërish dëshmitarin në sallë.

5 Faleminderit.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit, Dëshmitar.

9 Avokat, keni fjalën.

10 [Mbrojtja këshillohet]

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

12 Thashë pa dashje që përfundova kundërpyetjet, po në fakt
13 ishin pyetjet e mia. Nuk kam më pyetje.

14 PY. Thjesht falënderoj Dëshmitarin, ka qenë një ditë e gjatë,
15 ka pasë shumë pyetje. Ju faleminderit, Dëshmitar.

16 PË. Faleminderit edhe juve.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 rregull. Prokuror, është ora 10.30. Si të dëshironi. Doni të
19 bëni tani pushimin dhe të filloni me kundërpyetjet, nëse keni
20 kundërpyetje. Nuk e di.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kam pyetje, po. Do preferonim
22 që të bënim një pushim tani.

23 Siç ju thashë dhe në fillim të seancës, ne kërkua që të
24 shtoheshin dy materiale në listën tonë të prezantimeve. Dhe
25 synimi im është të filloj me materialet, nëse ju më jepni leje

1 që t'i përdor, kështu që kundërpyetjet do t'i fillojmë me
2 materialet që kam kërkuar që të shtoni në listën time.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
4 rregull. Do t'i lejojmë materialet, pasi nuk ka pasë as
5 kundërshtime për t'i përdorur as nga palët, as nga Mbrojtësi i
6 Viktimave. Edhe janë materiale që janë nxjerrë, kështu që nuk
7 ka asnjë problem.

8 Mirë atëherë. Unë s'kisha mbaruar pyetjen. Si rregull ne
9 pushimin e bëjmë gjysmë ore. Ju mjafton ju nga ana e
10 Prokurorisë gjysëm ore pushim?

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

13 Dëshmitar, tani do bëjmë pushim deri në orën 11.10 dhe
14 pastaj do vazhdojmë me kundërpyetjet nga Zyra e Prokurorit të
15 Specializuar. Edhe pastaj, nëse ka Mbrojtësi i Viktimave do
16 bëj ai pyetje dhe në fund të kenë pyetje Gjykatësit e panelit.

17 Tani Asistentja do t'ju shoqërojë jashtë sallës së gjyqit
18 dhe do shihemi bashkë për gjysëm ore.

19 DËSHMITARI: Në rregull. Faleminderit.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Në rregull. Bëjmë pushimin.

24 --- Pauza fillon në orën 10.38

25 --- Seanca rifillon në orën 11.11

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
2 se u kthyet.

3 ZPS-ja shoh që ka të njëjtin ekip. E njëjta gjë vlen për
4 Mbrojtësin e Viktimave. Dhe në të majtë po të njëjtët persona
5 janë të pranishëm.

6 Në rregull, vazhdojmë me kundërpyetjet nga Prokuroria.

7 Asistente, ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

8 Dhe po ashtu, marr parasysh Avokat që keni përdorur katër
9 orë e shtatë minuta, kështu që shkëlqyeshëm.

10 Ndërkohë që presim dëshmitarin, Prokuror, sa kohë keni
11 parashikuar për kundërpyetjet tuaja?

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Besoj se e gjithë dita sot dhe
13 shpresoj të mbarojmë brenda orës 16.00. Nëse jo, do më duhet
14 edhe pak kohë nesër, po në varësi se si do shkojë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Dëshmitar, mirë se erdhët.

20 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me sa
22 kuptova më dëgjuat. Por do pyes z. Shala tani, a na dëgjon, z.
23 Shala?

24 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj shumë
25 mirë.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po

2 dëshmitarin e dëgjuat kur foli?

3 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Prokuror, fjala është për ju.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

7 Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk:

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

9 PY. Z. Hoxha, mirëmëngjesi.

10 PË. Mirëmëngjesi.

11 PY. Unë jam përfaqësues i Prokurorisë, dhe do t'ju bëj disa
12 pyetje për pjesën e mbetur të ditës.

13 Z. Hoxha, dje kur ju bënte pyetje Mbrojtja, ju thatë se
14 keni shkuar në Kukës më 22 a 23 prill të 1999. Ka qenë në
15 faqen 9 kjo, rreshtat 17, 23 të transkriptit të ditës së
16 djeshme.

17 Ju ama keni thënë tjetër gjë kur ju ka intervistuar
18 Prokuroria. Ju keni thënë që keni shkuar më 22 ose 23 maj të
19 1999, dhe unë do t'ua sqaroj këtë.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Por për ta bërë këtë, i lutem
21 Sekretares së Gjykatës të shohim një videoklip shumë të
22 shkurtër, që ka numrin ERN 077857B, Pjesa 1.

23 PY. Kjo është pjesa, është intervista që i keni dhënë
24 Prokurorisë, z. Hoxha, dhe këtu përmendni ditët kur keni
25 shkuar në Kukës. Ndiqni videoklipin dhe dëgjoni çfarë keni

1 thënë vetë në lidhje me këtë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni.

4 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja këshillohen]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Prokuror, që të jemi të sigurt, duhet të keni parasysh që kjo
7 do të jetë me audio dhe audioja do të përkthehet.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, në rregull.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull.

11 Sekretare, atëherë vazhdoni.

12 [Luhet videoincizimi]

13 "PY. A mund të na jepni datën e përafërt kur keni ardhur
14 në Kukës.

15 "PË. Diku ka qenë nja 23 ose 23 maj.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund të shohim menjëherë dhe
17 videoklipin e dytë? Që ta shohë dëshmitari. Është video me ERN
18 07857B [Sipas përkthimit], Pjesa 2, pjesërisht, pra *partial*.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 rregull.

21 [Luhet videoincizimi]

22 "PY. Desha të konfirmoj dhe një herë çfarë viti
23 mbërritët ju në Kukës, që thatë në maj?

24 "PË. Në maj të 1999."

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 PY. Z. Hoxha, nga këto dy videoklipe që pamë, ju jeni në këto
2 regjistrime. Është e qartë që dy herë kur ju ka intervistuar
3 Prokurori, ju qartazi keni thënë se keni shkuar në Kukës më 22
4 a 23 maj të 1999; s'është kështu?

5 PË. Po, me i ndëgju i ndëgjova të dy klipet. Klipi i parë nuk
6 u ndëgju mirë, faktikisht, muajin se kur kam shkue. Klipin e
7 dytë e ndëgjova shumë mirë, e ndëgjova, por ka qenë gabimisht.
8 Unë e kam gabue, jo faktikisht transkripti. Por unë e kam
9 gabu. Se, faktikisht, të gjitha këto aktivitete sa i kam pasë
10 unë në uzinën e Kukësit, mbrenda një javë ditë s'kam mujtë me
11 i arritë gjithë ato punë. Se prej 22, 23 prillit deri më 6
12 qershor, prej prillit faktikisht, prej majit deri në qershor,
13 aty po i bjen diku dhjetë ditë që kam qëndru krejt. Unë kam
14 qëndru dikund për mbi një muaj e gjysmë kam qëndru në atë
15 uzinë. Është data gabimisht që e kam dhanë.

16 PY. E vetmja gjë që mua më befason, z. Hoxha, është se nuk e
17 keni thënë një herë. E keni thënë herën e parë, dhe në një
18 intervistë tjetër, me të njëjtin Prokuror, keni përsëritur të
19 njëjtën datë. Keni thënë po ashtu 22 ose 23 maj të 1999.

20 Pra ju, tani po thoni që ka qenë prill koha kur keni
21 shkuar në Kukës?

22 PË. Po, jam i sigurt që ka qenë prill.

23 PY. Po mirë, pse i keni thënë Prokurorit atëherë që ka qenë
24 maj dhe prill?

25 PË. Pse, nuk e di as vetë. Faktikisht, gabim. Gabimisht kam

1 deklarue.

2 PY. Z. Hoxha, flasim për një temë tjetër tani. Dje gjatë
3 pyetjeve të Mbrojtjes, dhe kjo është reflektuar në faqen 12,
4 rreshtat 20, 22 të transkriptit të përkohshëm, ju thatë përveç
5 uzinës së metalit në Kukës, ju keni "shkuar për të riparuar
6 armë në Krumë, në Cahan dhe në vende të tjera."

7 Tani do t'ju bëj disa pyetje lidhur me këto vendet që
8 përmendët.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sekretare, a mund të vendosim
10 në ekran dokumentin SPOE00127400.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
12 për ç'qëllim, Prokuror?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua të tregoj hartën e Kukësit.
14 Dëshmitari përmendi disa vende dhe doja t'i shënonte në hartë
15 në raport me Kukësin. Për të parë distancën mes këtyre vendeve
16 dhe për të komentuar në lidhje me to.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
18 rregull.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund ta zmadhojmë pak hartën,
20 ju lutem. Kukësi duhet të jetë në qendër dhe duhet të shohim
21 dhe Krumën, duhet të shfaqet dhe Kruma.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
23 humbëm Krumën.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Atëherë duhet të zbresim
25 poshtë, lart më saktë. Pak më shumë, ju lutem. Shumë mirë

1 këtua.

2 PY. Z. Hoxha a mund të rrethoni me lapsin që do jua japi
3 Asistentja, pra, ju lutemi, rrethoni Kukësin. Rrethojeni.

4 PË. [Shënon]

5 PY. Vendosni numrin 1 ju lutem.

6 PË. [Shënon]

7 PY. Faleminderit. E shihni Krumën në hartë? Nëse po,
8 shënojeni dhe këtë vend.

9 PË. [Shënon]

10 PY. Mund të vendosni numrin 2 afër?

11 PË. [Shënon]

12 PY. A shihni në hartë Cahanin, Cahanin? E përmendët dje,
13 rrethojeni dhe këtë, po. Dhe vendosni numrin 3.

14 PË. [Shënon]

15 PY. [Nuk ka përkthim]

16 PË. Më falni, nuk e ndëgjova përkthimin.

17 PY. Po, do ta përsërisim se kishim mikrofonin e fikur. Sipas
18 dëshmisë që ju dhatë dje, ju thatë që:

19 "... shkonim për t'i marrë armët, i çonim në Kukës për
20 t'i riparuar. Megjithatë, në qoftë se nuk kishte ndonjë defekt
21 të madh, qëndroje atje dhe i rregulloje aty në vend."

22 Kështu?

23 PË. Po, kështu kam deklaruar.

24 PY. Z. Hoxha, si shkoje në këto, si shkoje në Cahan dhe në
25 Krumë, me çfarë mjete transporti?

1 PË. Po, faktikisht, deri në Krumë kemi mujtë me shku dhe me
2 veturë të vogël, përndryshe për në Cahan, pa qenë xhip, nuk ke
3 mujtë me shku në Cahan. Se ka qenë rruga shumë e keqe, ka
4 qenë, dhe nuk kemi mujtë me depërtue. A deri në Krumë kemi
5 mujtë edhe me vetura të vogla me shku. A në Cahan, jo. Pa qenë
6 xhip nuk kemi mujtë.

7 PY. Në rregull. Të diskutojmë udhëtimet në këto vende, një
8 për një.

9 Flasim fillimisht për Krumën. Sa është distanca mes
10 uzinës së metalit të Kukësit dhe Krumës, vendit ku shkonit ju?

11 PË. A nuk e di, me kilometra nuk e di. Sa është largësia nuk
12 e di. Përndryshe me veturë, dikund dy orë i bojshim, dy orë e
13 gjysmë.

14 PY. Dy orë vetëm për të shkuar, një drejtim, ë? Nga Kukësi në
15 Krumë, këtë po thoni?

16 PË. Një drejtim, se ka qenë rruga shumë e keqe ka qenë dhe
17 s'kemi mujtë me vozitë.

18 PY. Në fakt, doja t'ju pyesja edhe për kushtet e rrugës. A
19 mund t'i tregoni Trupit Gjykues si ishte rruga? Ishte me
20 asfalt, ishte me baltë, ishte me zhavorr? Si ishte rruga?

21 PË. Po, faktikisht, ka qenë pjesë-pjesë. Ka pasë pjesë me
22 asfalt, ka pasë të pashrume. Kanë qenë rrugë të shkatërrume,
23 në një farë mënyre. Nuk kemi mujtë me zhvillu shpejtësi nëpër
24 ato rrugë.

25 PY. Rruga ka qenë e drejtë, ka qenë me kthesa? Gjarpëruese?

1 Si ka qenë?

2 PË. Jo, rruga ka qenë gjarpërore, faktikisht, qysh edhe
3 shifet edhe në hartë.

4 PY. Rruga kalonte përmes maleve apo pjesërisht në mal? Në
5 terren malor, si mund të na -- apo në terren të sheshtë, si
6 mund ta përshkruani?

7 PË. Tash s'më kujtohen ato detale, nuk më kujtohen. Më fal,
8 por s'më kujtohen.

9 PY. Thatë që në Krumë mund të shkoje me një veturë normale,
10 dhe jo me xhip, kështu?

11 PË. Po, ashtu është.

12 PY. Dëshmitar, dua t'ju tregoj dëshminë që ka dhënë eprori
13 juaj, në UÇK, z. Mark Shala. Ai dha dëshmi në këtë Gjykatë më
14 24 tetor 2023.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk është nevoja ta shfaqim në
16 ekran, do ju lexoj unë një pjesë.

17 PY. Në faqen 3400 [Sipas përkthimit] të transkriptit, z.
18 Shala pati këtë komunikim me Prokurorin, që i bënte pyetjet.

19 "PY. Sa kohë duhej për të shkuar në Krumë nga uzina e
20 Kukësit?

21 Përgjigjja e z. Shala ka qenë:

22 "PË. Kushtet e rrugës ishin të vështira. Vetë rrugët
23 ishin të prishura. Zakonisht shkonim me xhip, fuoristradë,
24 xhip, sepse makinat, veturat e vogla nuk kalonin dot në atë
25 rrugë."

1 Pra, Mark Shala nuk ka thënë që mund të shkoje me veturë
2 të vogël. Ai tha që vendi në Krumë, pra në Krumë shkoje vetëm
3 me xhip. Pajtoheni ju me z. Shala apo jeni ende, mbani ende
4 qëndrimin që në atë vend mund të shkoje me veturë të vogël?
5 PË. Jo, unë pajtohena me deklaratën e komandant Markut, por
6 komandantët zakonisht i kanë pasë xhipat e rezervumë, i kanë
7 pasë për terren jo të përshtatshëm. Përndryshe, kemi mujtë me
8 shku edhe prej Kukësit deri në Krumë, kemi mujtë me shku edhe
9 me veturë të vogël. Por komandantët kanë qenë diçka tjetër
10 faktikisht se është deshtë me pasë sigurinë ma të madhe. Na si
11 ushtarë nuk kemi mujtë me zgjedhë me çfarë veture me shkue.
12 PY. E kuptoj plotësisht atë që po thoni, por do përsëris atë
13 që ka thënë Mark Shala. Ka qenë:

14 "... xhip, fuoristradë, 4 me 4, sepse makinat e vogla nuk
15 shkonin dot atje."

16 A pajtohesh me z. Shala lidhur me këtë pikë?

17 PË. Pajtohena me z. Shala, por me fuoristradë, 4 herë 4, na u
18 ka nevojitë ma së shumti për Cahan për me shku, jo për Krumë.
19 Për Cahan. Se është terreni shumë i papërshtatshëm. Se Kukës-
20 Krumë faktikisht kanë qarkullu edhe mjetet e vogla, kanë
21 qarkullu edhe qytetarët. Se ajo është rrugë kryesore për atë
22 pjesë. Po me siguri është keqkuptu deklarata e tijna. Me
23 fuoristradë, me 4 herë 4, është deshtë me u ngjitetë vetëm prej
24 Krumës për Cahan. Me shku në kufi, faktikisht.

25 PY. Z. Hoxha, gjatë qëndrimit tuj në Kukës në 1999, sa herë

1 keni shku në Krumë?

2 PË. Nuk e di. Minimumi, dhjetë herë po.

3 PY. U keqkuptova, minimumi, dhjetë herë, po.

4 [Nuk ka përkthim]

5 PË. Nuk kam përkthim.

6 PY. Kur keni ndejtë në Krumë, sa kohë keni ndejtë aty?

7 PË. Mbrenda ditës, faktikisht, jemi kthi për Kukës. Ka
8 ndodhë, dy orë, tri orë, katër orë. Edhe jemi kthi mbrapa për
9 Kukës.

10 PY. Pra, që ta bëjmë një përmbledhje. Dy orë prej Kukësi në
11 Krumë, dy orë me u kthi, edhe tre-katër orë që keni ndejtë
12 aty, në Krumë, a është kështu?

13 PË. Po, ashtu është.

14 PY. Kur keni marrë armë me vete që i keni çu në Kukës, për me
15 i riparuar, prej Krume në Kukës -- mbasi i keni riparuar, a i ke
16 kthi ti në Krumë prapë?

17 PË. Jo, nuk i kam kthyer në Krumë. Jo, faktikisht, qysh në
18 fillim -- t'ju shpjegoj diçka. Kur e kam marrë këtë detyrë për
19 riparimin e armëve, jam marrë vesh me komandant Markun që çdo
20 armë që ta riparoj, ma së pari me e provu unë a është në
21 gjendje të rregullt apo jo. Tek masanej me ia dhanë ushtarit.
22 Përndryshe e kemi pasë një depo të vogël e kemi pasë në uzinë,
23 çelësat vetëm unë i kam pasë, edhe i kam deponue aty. Kur ka
24 pasë nevojë, ato armë i ka marrë komandanti e i ka dorëzu
25 tjetërkujna.

1 PY. E qartë. Faleminderit shumë.

2 Atëherë, flasim për vendndodhjen pra, Cahanin. Sa është
3 distanca prej uzinës mekanike në Kukës deri te ky vendi në
4 Cahan, që e përmende? Ose, me kilometra ose sa kohë është
5 dashtë me shku deri atje?

6 PË. Me kilometra nuk e di, por faktikisht, prej Kukësi deri
7 në Krumë prej Krume deri në Cahan, dikund afër tri orë, tri
8 orë e gjysmë. Tri orë e gjysmë dikund i bojsha. Nuk e di
9 saktësisht.

10 PY. Si ishte gjendja e rrugës për në Cahan, qysh kishe mujtë
11 me e përshkru ti, si ishin kushtet e rrugës?

12 PË. Po faktikisht ajo ka qenë rrugë malore, nuk ka qenë as e
13 shtrume as kurrëgjë hiç. Në njifarë mënyre ka qenë rrugë
14 malore. Aty ose kanë dashtë me pastë fuoristradë, ose me
15 traktor me depërtu atje lart, përndryshe me veturë të vogël
16 shans nuk ke pasë.

17 PY. A ka qenë rrugë kështu me kthesa?

18 PË. Po. Edhe ka qenë shumë e ngushtë, ka qenë. Dy vetura me u
19 taku njona nga ana e kundërt, tjetra në tjetrën anë nuk kanë
20 mujtë me tejkalu njëna-tjetrën. Ka qenë vetëm një vend në mes
21 të asaj rruge që ka mujtë [E pakuptueshme] me ia lëshu njana
22 veturë tjetrës. Se përndryshe ka qenë shumë e ngushtë.

23 PY. A ka qenë e asfaltume, e paasfaltume, si ka qenë kështu?

24 A ka qenë e shtrume?

25 PË. Jo, jo, ka qenë pa asfalt, faktikisht, gur krejt, komplet

1 guri ka qenë. Edhe kah të shkojsh përpjetë në anën e djathtë
2 ka qenë humnera më se 200 metra thellë. Me bo rastësisht me
3 rrëshqitë, gjallë s'ke mujtë me pështu aty.

4 PY. Gjatë kohës që ke qëndru në Kukës në 1999, sa herë ke
5 shku në Cahan?

6 PË. Në Cahan mund të kem shku dikund katër herë, apo pesë
7 herë kam qenë.

8 PY. Kur ke shku në Cahan, sa kohë ke ndejtë aty zakonisht?

9 PË. Zakonisht tri katër orë dhe jam kthi mbrapa. Po s'kam
10 qenë vetëm, s'kam qenë asnjherë, faktikisht, në Cahan, vetëm
11 s'kam qenë asnjherë. Gjithmonë e kam pasë një shofer me vete.
12 Unë për vete nuk kam pasë guxim në qatë rrugë me vozitë. Edhe
13 pse unë voziti përmbi tridhjetë vjet, por nuk kam pasë guxim
14 në atë rrugë me vozitë. Ka qenë rrugë shumë e rrezikshme.

15 PY. A ka ndodhë ndonjëherë që keni fjetë në Cahan?

16 PË. Jo, nuk ka ndodhë asnjherë.

17 PY. Që ta bëjmë një përmbledhje. Tre orë e gjysmë me shku,
18 tri orë ose tri orë e gjysmë me u kthi, edhe tre-katër orë me
19 ndejtë aty në Cahan. A i bie qashtu?

20 PË. Po.

21 PY. Z. Hoxha, në faqen 12, rreshtat 20, 22 të transkriptit të
22 përkohshëm të dëshmisë tuj të djeshme, ke thënë që përveç
23 Krumës dhe Cahanit, ka ndodhë që të kanë thirrë me shku me
24 riparë armë edhe "në vende të tjera".

25 Tash, duke pa këtë hartën që e kena këtu përballë, a mund

1 të na, edhe t'i shënosh në hartë aty, vendet ku ke shku për,
2 në vendet të tjera domethënë që ke shku me riparuar armë edhe me
3 marrë armë?

4 PË. Jo, vende të tjera nuk kam shku me riparuar armë,
5 faktikisht, vende të tjera e kemi pasë vetëm me i furnizuar, por
6 furnizim nuk kam shkue unë. I kam pasë kolegët e mi që kanë
7 shku me armatim së bashku edhe i kanë furnizuar pikat e
8 luftimeve.

9 PY. Z. Hoxha, t'i lëmë këto riparimin apo furnizimin me armë,
10 por dje keni thanë në ato rreshtat që i përmendëm, keni thënë
11 që keni shku edhe në vende të tjera. Pyetja ime është, për
12 cila vend e kishit fjalën kur keni thënë që kam shku edhe në
13 vende të tjera.

14 PË. S'më kujtohet që kam thanë edhe në vende të tjera.
15 Faktikisht, unë i kam pasë këto tri pika, i kam pasë.
16 Përgjegjësinë që këto tri pika i kam pasë.

17 PY. Pra, dëshmia jua tani është që përveç Cahanit dhe
18 Krumës, përveç këtyre dy vendeve, nuk keni shku tjetërkund
19 jashtë Kukësit. A është kjo deklarata juaj?

20 PË. Për me riparuar, riparim jo, nuk kam qenë jashtë Kukësit.
21 Jashtë Kukësit, Krumës edhe Cahanit, faktikisht.

22 PY. Pyetja ime kishte të bënte edhe për arsye të tjera.
23 Domethënë, a jeni largu prej Kukësit, a keni udhëtuar diku
24 tjetër, në vende të tjera edhe për arsye të tjera, në vende të
25 tjera?

1 PË. Jo, zakonisht jo. Jo. Aty afër fshatra, faktikisht, afër
2 Kukësit po, kam qenë, ama më larg prej fshatrave të Kukësit,
3 jo. Se ka pasë një ditë faktikisht që kemi qenë nëpër vizita e
4 nëpër familjet e dëshmorëve që kanë qenë nëpër fshatra afër,
5 që kanë qenë refugjatë. Atëherë kam dalë prej Kukësit,
6 faktikisht, kam dalë me shokët së bashku me ta. Janë inçizmet
7 në fakt që kemi qenë në familje të dëshmorëve. Ato janë jashtë
8 Kukësit.

9 PY. A mund të shënoni në hartë fshatrat që, për të cilat po
10 flet?

11 PË. Ah, jo. S'më kujtohen. Më fal, por s'më kujtohen. 24
12 vjet, 25 vjet kanë kalue. Nuk i njof fshatrat e Prishtinës në
13 afërsi që jam le aty, faktikisht, nuk i njof fshatrat, e le ma
14 fshatrat e Kukësit. S'e di sa po më kuptoni.

15 PY. E kuptoj plotësisht. I përmendët fshatrat e vogla rreth
16 Kukësit. Sa, në sa raste ke shku, sa shpesh, sa herë ke shku
17 në këto fshatra të vogla rreth Kukësit?

18 PË. Po neve faktikisht kemi dalë me shokë në vizita të
19 familjeve të dëshmorëve, edhe më ka ndodhë katër herë apo pesë
20 kam qenë në Kolsh. Se aty kemi pasë poligonin për provimin e
21 armëve, faktikisht, me i provu armët a janë në gjendje të
22 rregullt apo jo.

23 PY. T'ju pyes për këto dy vendet atëherë. Së pari Kolshi. Me
24 sa duket keni shku te ky vendi në Kolsh, ku ka qenë poligoni.
25 Pyetja ime është, në këtë hartën që e shikoni aty, a shifni

1 këtë vendin, Kolsh? Në qoftë se e shifni, ju lutem rrethojeni
2 me laps.

3 PË. [Shënon]

4 PY. Vendosni numrin 5 [Sipas përkthimit] afër saj ju lutem.

5 PË. [Shënon]

6 PY. Faleminderit. Pra, na thatë që keni qenë në Kolsh. Pesë
7 herë nëse më kujtohet, na thatë kështu?

8 PË. S'më kujtohet saktësisht sa herë, pesë herë, gjashtë
9 herë. Nuk e di saktësisht. Saktësisht, nuk e di se nuk kam
10 mbajtur evidencë sa herë kam qenë faktikisht.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

12 Dëshmitar, a mund ta shënoni Kolshin me numër 4, shënojeni me
13 4 edhe një herë sepse nuk po shifet qartë në hartë.

14 DËSHMITARI: [Shënon]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit.

17 Vazhdoni, z. Prokuror.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

19 PY. Z. Hoxha, për çfarë arsye ke shku në Kolsh?

20 PË. Në Kolsh faktikisht kam shku me i provu armët si i kam
21 riparuar në uzinë. Se atje ka qenë faktikisht edhe një kazermë e
22 ushtrisë tonë, ka qenë. Ka qenë poligoni përndryshe unë në
23 Kukës nuk ka pasë poligon ku me i provu armët, a janë ende me
24 defekte apo janë riparuar. Se unë s'kam qenë i sigurt 100 për
25 qind a është arma e riparuar apo jo. Edhe nuk kam dashtë me ia

1 dhanë një ushtari një armë me defekt pa e provu vetë që është
2 në gjendje të rregullt.

3 PY. A kuptoj mirë që, domethënë, çdo herë që ke riparuar armë,
4 sa herë ke shku, sa herë ke riparuar armë, ke shku në Kolsh për
5 me i provu edhe para se me ia dorëzuar ushtarëve, a është
6 kështu?

7 PË. Po, kur janë grumbullu 20, 30 copë për shembull, 20, 30
8 armë, ose 30-40 armë, atëherë i kam ngarku në xhip ose në
9 një kamion. Kemi shku në Kolsh, i kam provuar të gjitha, ato
10 që kanë dalë në rregull i kemi nda anash, ato që kanë pasë
11 ende defekte, i kemi nda anash me ka krejt edhe jem kthyer
12 mbrapa në Kukës.

13 PY. A ju kujtohet distanca prej Kukësit në Kolsh, ose me
14 kilometra ose me kohë që është dashtë me shku deri atje?

15 PË. Me kilometra nuk e di, diku një orë, një orë, nuk është
16 ma shumë.

17 PY. Si ka qenë rruga? Në gjendje të mirë, a në gjendje të
18 keqe, apo e ngjashme si ajo me shku në Krumë, apo e ngjashme
19 si ajo me shku në Cahan?

20 PË. Po pjesë-pjesë faktikisht ka qenë. Pjesë-pjesë ka qenë e
21 asfaltume, pjesë-pjesë ka qenë e shkatërrume. Përndryshe, nuk
22 ka qenë e mirë. Qysh janë sot, në ditën e sodit, jo.

23 PY. Kur ke shku te ky vendi në Kolsh, sa kohë ke ndejtë aty
24 zakonisht?

25 PË. Po zakonisht kam ndejtë derisa i kam provuar të gjitha

1 armët, aty nuk e di me kohë, nuk e kam matë kohën, çfarë kohe.
2 Se unë për tjetër punë nuk kam shku, vetëm me i provu ato armë
3 edhe me u kthy mbrapa. Ka ndodhë gjysmë ore, ka ndodhë një
4 orë, ka ndodhë dy orë. Tash mvaret prej armatimit, sa kam pasë
5 armatim me vete.

6 PY. E kuptoj. Pra, një orë me shku, e një orë me ardhë, me u
7 kthy, edhe një deri në tre orë me ndejtë aty me i provu armët,
8 a është kështu?

9 PË. Po, në rregull.

10 PY. A ka ndodhë ndonjëherë që ke ndejtë aty, ke fjetë aty? Në
11 atë vend në Kolsh?

12 PË. Jo, nuk ka ndodhë asnjëherë.

13 PY. Një pyetje për këto fshatrat e vegjël që përmende, që
14 thatë që i ke shku. Sa larg kanë qenë këto fshatra nga uzina
15 mekanike, këto fshatra ku ke shku në 1999?

16 PË. Ah, nuk e di. Nuk e di, saktësisht nuk e di, por
17 faktikisht atë ditë kur kemi dalë në vizita të familjeve,
18 thuja që tanë ditën e kemi hupë nëpër familje të dëshmorëve.

19 PY. Pra, përveç se ke shku në Krumë, Cahan, Kolsh, e ky
20 fshati për martirët -- për dëshmorët, a ke shku në nanji vend
21 tjetër jashtë Kukësit?

22 PË. Po në qoftë se e llogaritni jashtë Kukësit, te Drini i
23 Bardhë kur i kemi ushtru ushtarët, faktikisht, për gardën e
24 nderit, është krejt diçka tjetër. Po ajo është mbrenda
25 Kukësit. Dikun tjetër nuk kam qenë.

1 PY. Do të bëj disa pyetje lidhur me këto ngjarje pak ma vonë.

2 Veç kini pak durim.

3 Z. Hoxha, ne kuptojmë nga dëshmia juaj, që në 1999 kur
4 keni qenë në Kukës, keni inçizu disa video të varrimeve të
5 ushtarëve të UÇK-së që kishin rënë në luftë, a është kështu?

6 PË. Po, korrekt.

7 PY. Gjithashtu disa herë keni konfirmu që personi që i ka
8 filmu këto ceremoni keni qenë ju, a është saktë?

9 PË. Po.

10 PY. Ndoshta s'e kam kuptu qartë drejt, a mund të na sqaroni
11 në total në sa varrime, ceremoni varrimi, keni marrë pjesë ju
12 vetë personalisht?

13 PË. Unë personalisht kam marrë pjesë faktikisht në tri
14 varrime.

15 PY. A e keni fjalën për këto tre varrime që i keni diskutu
16 edhe dje me Mbrojtjen, a janë këto për të cilat e keni fjalën?

17 PË. Po, këto janë të gjitha.

18 PY. Që ta kuptojmë qartë, a keni marrë pjesë në ndonjë varrim
19 tjetër ku s'keni filmu? Bëhet fjalë për këtë periudhë kohore,
20 në 1999.

21 PË. Jo, nuk kam marrë pjesë.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
23 kërkoj që të shfaqen në ekran një ose dy fotografi. Arsyeja
24 është se ne dëshirojmë t'i tregojmë fotografitë, dëshmitarit
25 disa vende dhe ta, që kanë të bajnë me ceremoni varrimi.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

2 lutem jepni numrin ERN.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
5 në rregull.

6 Por sapo më thanë që fillimisht duhet të ruhet ky
7 dokument.

8 Dhe kështu që, ju lutem, ruajeni dokumentin dhe caktojini
9 një numër të tij.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga
11 dëshmitari W03887, në dokumentin me ERN SPOE001287400 [Sipas
12 përkthimit] do t'u jepet numri i provës REG00991.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit, znj. Sekretare.

15 Një informacion shtesë. Do vazhdojmë deri në 12.30 [Sipas
16 përkthimit] do ndryshojmë pak programin e punës sot pasdite,
17 por për tani e dimë që do bëjmë pushimin e drekës pak më herët
18 që ta dini dhe ju, z. Prokuror, për t'u organizuar me pyetjet
19 tuaja.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E kuptoj, a mund të vazhdoj ju
21 lutem?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
23 të vazhdoni.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund ta
25 shfaqni në ekran dokumentin me numër DPS00159 deri në

1 DPS00161. Hedhim një sy faqes numër 1.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni ju lutem, znj. Sekretare.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

5 PY. Z. Hoxha, e shihni këtë fotografi që është përpara jush?

6 PË. Po, e shof.

7 PY. Në dëshminë tuaj dje, këtu i referohem faqes 81, rreshtat
8 13, 14, keni deklaruar si në vijim, duke folur për varrezat në
9 Kukës, keni thënë:

10 "Kjo është në rrugën mes Kukësit dhe Krumës. Rruga për në
11 varreza, bëhet fjalë. Është rruga kryesore."

12 A mundeni t'i gjeni varrezat në këtë hartë, varrezat e
13 Kukësit?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A ka mundësi që ta zmadhojmë
15 pak këtë hartë ndoshta? Ndoshta kaq mjafton.

16 Kështu duket mirë.

17 PY. Tani pyetja ime përsëri është, a jeni në gjendje t'i
18 identifikoni varrezat në këtë hartë në këtë, varrezat e
19 Kukësit? Në qoftë se mund t'i gjeni këtu ju lutem rrethojini
20 me laps.

21 PË. [Shënon]

22 PY. Faleminderit. Vendorsni numrin 1, ju lutem, afër këtij
23 rrethit.

24 PË. [Shënon]

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë

1 se numri është mjaft, shihet qartë?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mjafton.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

5 PY. Z. Hoxha, a mund të rrethoni, në qoftë se mundeni
6 natyrisht, uzinën mekanike në Kukës në këtë hartë në qoftë se
7 e gjeni?

8 PË. Nuk jam i sigurt veç në qoftë se është qetu te kjo, është
9 kjo pika e kuqe, mundet me ndodhë, por përndryshe nuk jam i
10 sigurt ku është.

11 PY. Në rregull. A mund të na tregoni sa larg janë varrezat
12 nga uzina mekanike? Ose me kilometra ose sa, me kohë, sa duhet
13 me shku?

14 PË. Po dikund afër 1 kilometër është.

15 PY. Z. Hoxha, dje dhe sot kemi pa disa video, inçizime,
16 njerëz që largohen nga uzina mekanike në Kukës, e që shkojnë
17 në rresht në Kukës në qytet, bashkohen, grumbullohen te
18 varrezat. A mund të na thoni me këtë grupin që ka marrë pjesë
19 në ceremoninë e varrimit, sa kohë është dashtë me shku prej
20 uzinës deri te varrezat, sa kohë të është dashtë?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po?

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
24 prisni, prisni. Keni ndonjë vërejtje për të bë që dëshmitari
25 nuk duhet ta dëgjojë? Vazhdoni atëherë.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo. sapo pashë në transkript ku
2 thuhet që kanë shku në grup procesion, pra drejt në qytet në
3 Kukës. Ndoshta Prokurori ka patë fjalën me shku te varrezat
4 dhe jo në Kukës, ndoshta gaboju.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kjo ishte pyetja ime,
6 faleminderit për korrigjimin. Këtë desha të them në fakt që
7 nga uzina mekanike te varrezat, jo në Kukës.

8 Ndoshta duhet ta përsëris pyetjen.

9 PY. Pra, i pamë këto inçizime që i keni bë ju, njerëzit në
10 grup në rresht që shkojnë, nisen nga uzina mekanike dhe
11 shkojnë në qytet në Kukës, në varreza, te varrezat. Sa kohë
12 është dashtë zakonisht me shku, në këmbë në grup kështu siç
13 kanë shku në rresht?

14 PË. Po dikund prej uzine faktikisht deri te varrezat e
15 Kukësit ka zgjatë 20 minuta, 25 minuta. Saktësisht nuk e di se
16 s'e kam matë kohën asnjherë. Nuk e di saktësisht. Por them
17 për afërsisht 25 minuta, aty dikund.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Prokuror. Informacioni që ju përmendët përmes qytetit të
20 Kukësit nuk ishte, deri tani të paktën s'ishte këtu.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pyetja ime u formulua në këtë
22 mënyrë, sepse në shumë imazhe pamë njerëz që ecnin në qytet
23 dhe në qoftë se i referohemi kësaj harte, varrezat janë jashtë
24 qytetit. Domethënë kudo që qoftë kjo uzina mekanike, duhet të
25 jetë përpara varrezave, që i bie në qytet, ose të paktën në

1 një pjesë të qytetit. Të paktën unë kështu e kam kuptu. Në
2 qoftë se s'isha i qartë ndoshta mund --

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
4 e qartë, por do të kisha preferuar që të mos ndahet në këtë
5 mënyrë ky informacion. Tani që e thatë, e thatë.

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] Në qoftë se -- gjeografikisht duhet
7 të shkoni përmes qytetit, të dilni nga qyteti dhe të shkoni
8 tek uzina mekanike.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
10 është ajo që po thoja dhe unë, nënvizova faktin që këto ishin
11 informacione të tepërta.

12 Z. AOUBINI: [Përkthim] Dhe gjeografikisht e pasaktë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këto
14 jua lë juve, sepse nuk dua të hyj në këtë debat. Thjesht doja,
15 tërhoqa vërejtjen se po ndajmë tepër, më tepër informacion se
16 sa duhet.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do përpiqem të jem i saktë. Ajo
18 që pamë në video ishin rrugë, ndërtesa, dhe për këtë e kisha
19 fjalën. Besoj që dëshmitari din se si ishin rrugës. Pra në
20 qoftë se ka ndonjë keqkuptim, ndoshta mund të kërkojmë sqarim
21 nga dëshmitari.

22 PY. Doni të sqaroni diçka?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Vazhdoni, dëshmitar.

25 DËSHMITARI: Po, deshta ta sqaroj se faktikisht prej

1 qytetit te varrezat kemi shku vetëm një herë. Është varrimi i
2 parë faktikisht i tre dëshmorëve që kanë qenë në spitalin e
3 Kukësit. Përndryshe, dy ceremonitë e varrimit, e dyta dhe e
4 treta është nisë kufoma, është nisë prej uzinës, jo prej
5 qytetit. Për qatë arsye unë në varrimin e parë, ku janë tre
6 dëshmorë, aty shifen faktikisht, shifet qyteti komplet. Se
7 kufomat kanë qenë në spitalin e Kukësit. Nuk kanë qenë te
8 uzina. Dhe duhet me i ra rrugës afër uzinës për me shku te
9 varrezat e Kukësit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 PY. E qartë, Dëshmitar. Shumë faleminderit për sqarimin që na
14 dhatë.

15 Thatë se ka qenë rreth 20, 25 minuta për ceremoninë,
16 domethënë, procesioni që shkonit nga uzina tek varrezat.
17 Përmendët dhe spitalin. Sa zgjaste, sa kohë duhej, pra, sa
18 kohë duhej që të shkoje tek arkivolet, dhe të fillonte
19 ceremonia mortore nga spitali drejt varrezave?

20 PË. Nuk e di saktësisht. Saktësisht nuk e di, nuk e di sa
21 kohë nevojitet faktikisht prej aty është bo vetëm varrimi i
22 parë. Faktikisht, kur janë varrosë tre dëshmorët e parë. Janë
23 tërhjekë prej morgut të spitalit të Kukësit. Faktikisht,
24 varrimi i Avdullah Gërdellajt është bo prej uzine, varrimi i
25 Gani Saramatit është bo prej uzine. Jo prej spitalit të

1 Kukësit. Atë rrugë e kemi përshku vetëm një herë, jo ma shumë.

2 PY. Në rregull, faleminderit për sqarimin.

3 Nga videot që diskutuat dje me ekipin e Mbrojtjes, ne
4 kuptojmë pasi arriti vargu tek varrezat, procesioni, ky grup
5 personash qëndroi dhe për një periudhë kohore tek varrezat.

6 Pamë dje që fillimisht u mbledhën njerëzit, u nisën drejt
7 varrezave, pastaj pamë fjalimin që u mbajt në ceremoninë
8 mortore. Dhe më pas pamë momentin që u ul, u fut arkëmorti në
9 varr, ushtarët vendosën kurorat edhe gjuajtën me armë në
10 formë, në shenjë simbolike, kështu?

11 PË. Po, kjo është e tëra.

12 PY. Sa kohë zgjati i gjithë, domethënë, nga momenti që
13 njerëzit mbërritën nga varreza dhe deri në momentin që u
14 larguan nga varrezat, sa zgjaste ceremonia?

15 PË. Po nuk e di, për afërsisht, nuk e di se nuk e kemi matë
16 kohën asnjherë, por për afërsisht dikund 40 minuta, një orë,
17 jo ma shumë.

18 PY. Veç ceremonive mortore, dje pamë në një nga videot --
19 ishte videoja 07538-01 [Sipas përkthimit]. Në video pamë
20 ushtarët e UÇK-së që praktikonin gjuajtjen me armë përpara se
21 të fillonte ceremonia mortore. Ju kujtohet ajo video që e pamë
22 dje?

23 PË. Më fal, edhe një herë. Nuk e kuptova pyetjen.

24 PY. Dje, në një nga videot që pamë dje, ishin ushtarët e UÇK-
25 së që po ushtronin, qëllonin me armë në ajër, por po

1 ushtronin, po përgatiteshin për ceremoninë mortore. Para se të
2 fillonte ceremonia mortore. Ju kujtohet kjo video?

3 PË. Po, më kujtohet shumë mirë bile.

4 PY. Ju thatë dje se ju e kishit inçizuar atë video. Është në
5 faqen 69 kjo, rreshti 3, i transkriptit të përkohshëm.

6 Dhe ju thatë po ashtu dje, po e thatë edhe sot, dje ishte
7 në faqen 69, rreshtat 19 dhe 20 të transkriptit. Pra ju thatë
8 që kjo ngjarje ndodhi pas Drinit të Bardhë, rreth 2 kilometra
9 larg uzinës së metalit në drejtim të Krumës, kështu?

10 PË. Kam thanë afër Drinit të Bardhë, jo pas Drinit të Bardhë,
11 por afër Drinit të Bardhë. Afër Drinit të Bardhë. I ka afër 1
12 kilometër e gjysmë, 2 kilometra aty i ka prej uzine.

13 PY. Kuptova. Megjithatë, është në drejtim të Krumës, kështu?
14 Në të njëjtën rrugë?

15 PË. Në të njëjtën rrugë.

16 PY. Sa kohë duhej që të shkoje atje?

17 PË. Nuk e di. Faktikisht, na kemi shkue atë ditë, kemi shku
18 me një furgon, me një bus, me thanë as dhjetë minuta jo.

19 Dhjetë minuta.

20 PY. Sa kohë qëndruat atje?

21 PË. A nuk e di saktësisht. Nuk e di. S'e kam matë kohën.

22 PY. E kuptoj. Nëse kujtojmë videon, ju fillimisht po inçizoni
23 një grup personash që ecin ngadalë përkrah lumit. Më pas në
24 video shohim që atyre u jepen disa udhëzime, më pas këta
25 gjuajnë me armë në ajër dhe më pas ktheheni.

1 A ju ndihmon kjo që t'ju kujtohet për afërsisht sa kohë
2 keni qëndruar në atë vend?

3 PË. Nuk di, për besë nuk e di. Nji orë e gjysmë, dy orë. Tri
4 ban vaki, nuk di. S'muj me thanë saktë asgjo.

5 PY. E kuptoj, faleminderit.

6 Do ndryshojmë pak temën. Por do mbetemi në Kukës, në
7 vitin 1999. Në cilin njësit, batalion apo brigadë i përkisnin
8 ushtarët që u varrosën në varrezat e Kukësit?

9 PË. Këta kanë qenë faktikisht ushtarë të brigadës së Ruzhdi
10 Saramatit.

11 PY. Por nuk ju kujtohet si e kishte emrin brigada, apo numrin
12 brigada. Që ta --

13 PË. Jo, nuk e di. Nuk e di. Nuk e di.

14 PY. Dje thatë se dëshmorët që u varrosën, ranë në betejën e
15 Gorozhupës, kështu?

16 PË. Po, kështu është.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për procesverbal, dëshmitari
18 këtë e ka thënë në faqen 69, rreshtat 6 deri në 13 të
19 transkriptit të përkohshëm.

20 PY. Gjithashtu dje, në faqen 78 të transkriptit, rreshti 12,
21 ju përmendët faktin që disa nga pjesëmarrësit në ceremoninë
22 mortore ishin nga brigada e Ruzhdi Saramatit. Pyetja ime është
23 kjo, a e din nga erdhën, prej cilit vend erdhën ata për të
24 marrë pjesë në ceremoninë mortore?

25 PË. Po sa kam dëgju faktikisht ata kanë ardhë nji pjesë kanë

1 ardhë prej frontit, për varrim të dëshmorëve. Në bazë të
2 fjalëve, se me ata s'kam bisedu, faktikisht fjalë i kam dëgju
3 që janë të njëjtit ushtarë të Ruzhdi Saramatit.

4 PY. Përmendët frontin. Sipas jush, ku ishte ky front, nga
5 cili front kishin ardhur këta ushtarë?

6 PË. Po faktikisht këta kanë qenë mbrenda në Kosovë. Ka qenë
7 edhe operacioni Shigjeta. Faktikisht, në një pjesë të
8 operacionit Shigjeta ka qenë edhe pjesa e Gorozhupit ku janë
9 vra këta dëshmorë.

10 PY. Pra, ju po thoni që këta dëshmorë, kanë rënë në
11 operacionin Shigjeta? Kanë rënë gjatë operacionit Shigjeta,
12 këtë po thoni?

13 PË. Po.

14 PY. Z. Hoxha, trupat e këtyre ushtarëve që u vranë po dhe ata
15 që u plagosën, si transportoheshin? Nga vendi ku ishte
16 operacioni, pra nga fronti në Kukës, me çfarë mjetesh
17 transporti, në qoftë se e dini?

18 PË. Ah, nuk e di se unë s'kam qenë në atë pjesë. Nuk muj me
19 të dhanë përgjigje.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më jepni
21 një çast të konsultohem pak me kolegët.

22 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

24 PY. Z. Hoxha, sot thatë që në një moment jeni takuar me
25 familjarët e dëshmorëve të rënë të UÇK-së, jashtë Kukësit, në

1 një prej fshatrave, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Na e thoni emrin, cila familje ishte kjo, familja e kujt?

4 PË. Kemi qenë te familja e Selver Maçkajt. Kanë qenë

5 refugjatë faktikisht në afërsi të Kukësit edhe kena shku.

6 Përndryshe është edhe një inçizim është.

7 PY. Në rregull, po.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Inçizimi që kemi është inçizimi
9 me numër 075138-01.

10 PY. Sa kohë qëndruat me atë familje.

11 PË. Nuk e di, dikund afër një orë. Një orë dikund.

12 PY. Në ç'drejtimit ishte ai fshat? Domethënë, në drejtim të
13 Kukësit, në drejtim të Krumës, në drejtim të veriut, në
14 drejtim të perëndimit, Kolshit? Në çfarë drejtimi, ju
15 kujtohet?

16 PË. Nuk di, nuk di. S'më kujtohet, s'më kujtohet. Më fal, por
17 s'më kujtohet.

18 PY. Sa kohë duhej për të mbërritur atje, pra, nga uzina deri
19 në atë vend? Sa kohë ishte, sa zgjaste?

20 PË. Më fal, por s'muj me t'u përgjigjë se nuk e di. Nuk e di
21 se unë s'e kam ditë që duhet me u përgjigjë dikund për me matë
22 kohën edhe orën sa po më nevojitet me shku dikund. Faktikisht,
23 na s'e kemi pasur orën e caktume. Nuk e di, s'mund me të dhanë
24 përgjigje. Më fal.

25 PY. Po më pak se një orë, më shumë se një orë? Nuk ke pse të

1 na japësh fiks, me për afërsi, nëse mundesh.

2 PË. Jo, jo. Me hamendje nuk foli. Më fal.

3 PY. Me të drejtë, okej.

4 Dje Mbrojtja ju tregoi një video 0751-01 [Sipas
5 për kthimit] dhe ju konfirmuat në faqen, konfirmuat dhe në
6 transkript se në video ishte morgu i spitalit të Kukësit nga u
7 morën trupat. A ju kujtohet kjo video për morgun, ku u morën
8 trupat?

9 PË. Po, më kujtohet shumë mirë bile. S'e harroj përjetë
10 kurrë.

11 PY. Sa kohë qëndruat në spital në atë rast?

12 PË. Diku, muj me thanë 10, 15 minuta, se kufomat kanë qenë
13 hazër, faktikisht veç kur kemi shku na me i marrë. Diku 10, 15
14 minuta.

15 PY. A ka pasur, a keni qenë në raste të tjera në atë spital?

16 PË. Po, kam qenë edhe një herë me shokë, faktikisht. Kur kemi
17 shku i kemi marrë intervista të plagosurve të tjerë. Kam qenë
18 edhe një herë.

19 PY. Po, e kemi në një nga videot, është video 075138-02, edhe
20 nga fillimi deri në minutën 8, duket kjo gjë.

21 Sa kohë, sa kohë keni qëndruar në spital për të biseduar
22 me të plagosurit në atë rast?

23 PË. Ah, nuk e di. S'e di sa kemi qëndru, nuk e di. S'më
24 kujtohet.

25 PY. Videoja është e gjatë. Po ose ju vetë po bisedonit me të

1 plagosurit në spital, ose po inçizonit një person që bisedonte
2 me të plagosurit në spital. A ju ndihmon kjo që t'ju kujtohet
3 kohë mund të keni qëndruar atje?

4 PË. Jo, unë e kam inçizu, faktikisht, se me intervistë s'kam
5 intervistë kurrkund. Por unë kam inçizu pa ndërprerje, kam
6 inçizu. Ata që kanë marrë në pyetje kanë qenë të tjerë, kolegë
7 kanë qenë. Por ka qenë e ndërpreme, faktikisht.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Dëshmitar, shoh Avokatin që u çua, duhet të gjejmë momentin e
10 përshtatshëm për ta ndërprerë dhe dëshmitarin.

11 Vazhdoni.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Ne nuk deshëm të ndërhyjmë, por
13 është shumë e vagullt pyetja, sidomos kur flitet për segmentet
14 e videos. Mund të jetë dhe sugjestionuese se ai thotë, ju po
15 flisni në video, por kjo, ne nuk e dimë të sigurt. Më mirë
16 t'ia tregojmë videon, të jemi më të saktë. Ai po inçizonte, ai
17 nuk po intervistonte apo po bisedonte me viktimat.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
19 kjo bëhet fjalë, po ju e keni fjalë vetëm për këtë pyetje. Ne
20 nuk ia kemi treguar videot, sepse Trupi Gjykes nuk ka menduar
21 që ka qenë e paqartë për dëshmitarin.

22 Prokuror.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, jo, nuk është qëllimi kush
24 po bisedonte me të plagosurit, më shumë doja që ta ndihmoja që
25 t'i kujtohej koha që ka, sa ka qëndruar me të plagosurit.

1 Megjithatë unë nuk kam më pyetje për këtë kështu që më mirë të
2 kalojmë në një temë tjetër.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
4 unë kam nevojë për një sqarim. Dëshmitari tha: "Po, isha
5 njëherë me shokët kur intervistua të plagosurit e tjerë".

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
8 kush po i intervistonte këta persona, dëshmitar?

9 DËSHMITARI: Faktikisht, i kanë intervistuar shokë të tonët,
10 ushtarë të tonët. Është Ismet Thaçi dhe Latif Fejzullahi.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Avokat, a ju ndihmoi kjo? Sepse në qoftë se ka ndonjë gjë të
13 paqartë preferoj që ta sqarojmë.

14 Z. AOUMINI: [Përkthim] Jo, është e qartë. Është e qartë,
15 thjesht donim që të ishim të saktë. Por ishte e dobishme.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull, faleminderit.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

19 PY. Z. Hoxha, tani flasim sërish për spitalin në Kukës. A
20 ishte spital i rregullt, ishte tamam spital, me të gjitha
21 pajisjet e një spitali?

22 PË. Po, faktikisht ai ka qenë spitali i qytetit, spitali
23 qendror i qytetit të Kukësit.

24 PY. A e dini çfarë pajisjesh kishte në atë kohë ky spital?

25 PË. Ahi, unë nuk di. S'kam punu në atë spital unë, si me

1 ditë. Më fal.

2 PY. Po ju keni qenë personalisht në atë spital. Keni vizituar
3 të plagosurit, keni kaluar ca kohë atje. Çfarë keni parë? Keni
4 parë ndonjë pajisje që është krejt normale të jetë në një
5 spital? Apo nuk kishte pajisje, kishte pak pajisje. Më shumë
6 apo më pak se një spital i rregullt. Ju keni qenë atje, s'kemi
7 qenë ne, prandaj po ju bëjmë këtë pyetje.

8 PË. Mu po më duket tregova, ka qenë spitali kryesor i qytetit
9 të Kukësit, dhe qytetit, faktikisht edhe i rrethinës së
10 Kukësit. Na kemi shku për vizitë të plagosurit që kanë qenë të
11 plagosur në Gorozhup. Me këta shokë të tjerë, të gjithë të
12 tjerët që faktikisht kanë ra edhe dëshmorë. Janë të njëjtës
13 betejë janë. Kemi shku për me i marrë në pyetje të na mbesë si
14 dokumentacion në njifarë mënyre, jo për diçka tjetër. Vetëm të
15 mbesë si dokumentacion.

16 Spitali si spital, faktikisht, shtretni, aparate aty
17 këtu, diçka tjetër të posaçme nuk kam vërejtë.

18 PY. Qartë. Ushtarët mjekoheshin në këtë spital?

19 PË. Po.

20 PY. Çfarë lloj trajtimi mjekësor merrnin atje?

21 PË. Po këta faktikisht të gjithë kanë qenë të plagosur. Këta
22 të gjithë kanë qenë të plagosur në Gorozhup, prej Gorozhupi i
23 kanë transportu faktikisht në spitalin e Kukësit. Edhe aty
24 kanë marrë ndihmën e parë, aty e kanë marrë shërimin. Bile një
25 prej tyre ende sot e kësaj dite është në karrocë, se nuk ka

1 pasë shërim.

2 PY. Kush i mjekonte këta ushtarët e plagosur? Doktorë, motra
3 medicinale, kush? Kush i trajtonte?

4 PË. Po me siguri që doktorët dhe motrat medicinale. Aty ka
5 qenë staf mjekësor, stafi i spitalit ka qenë, nuk e di. S'po
6 di si të përgjigjem.

7 PY. Në rregull. Dua që t'i kushtoni vëmendje atë që i keni
8 thënë ju vetë Prokurorit të ZPS-së. Është një dokument që ka
9 numrin 077857-TR-ET Pjesa 4, faqet 19 dhe 20, rreshti 24-25,
10 në faqen 19 dhe rreshtat 1 dhe 3 në faqen 20.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Janë
12 katër rreshta.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pesë rreshta.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
15 nuk do t'ia tregonit dëshmitarit, por është më e lehtë, por të
16 paktën citojeni.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do ta citoj fjalë për fjalë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Përpara se të, përpara se të vazhdojmë me materialin që sapo
20 përmendëm, është ende harta në ekran. Do të keni më pyetje për
21 hartën? Se përndryshe duam që ta ruajmë, që të mos humbasim
22 hartën sepse ka dhe shënime harta në të.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ja, më lejoni të shoh pak
24 pyetjet e mia. Besoj se nuk më nevojitet më harta.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 67

1 qoftë se ju nevojitet, ne mund ta nxjerrim sërish, por të
2 paktën ta ruajmë për momentin.

3 Sekretare, ju lutem, ruajeni këtë imazh dhe jepini numrin
4 e Zyrës Administrative, caktojini numrin e Zyrës
5 Administrative.

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] Më lejoni?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Patjetër.

9 Z. AOUBINI: [Përkthim] A mund të propozojmë që nëse do të
10 citoni fjalë për fjalë deklarata, është mirë që dëshmitari të
11 shohë versionin në gjuhën shqipe që edhe dëshmitari të ketë
12 mundësi që ta lexojë në gjuhën e vet. Në qoftë se do të
13 përdorim deklarata të mëhershme, është mirë që ta lexojë për
14 të qenë të saktë.

15 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja këshillohen]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
17 marrim përkthimin dhe është një fragment shumë i shkurtër.
18 Nëse unë e gjykoj më vonë të nevojshme sepse dëshmitari mund
19 të mos e kuptojë, atëherë do ta shfaqim në ekran. Në rregull?

20 Sekretare, fjala është për ju.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 shënimet që bëri dëshmitari 03887 në materialin me numër ERN
23 DPS00159 marrin numrin REG00992.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Prokuror, vetëm kini parasysh që keni dhe dhjetë minuta
2 para se të bëjmë pushimin.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, e di.

4 PY. Z. Hoxha, unë do ju lexoj fjalë për fjalë pyetjen që ju
5 ka bërë Prokurori gjatë intervistës dhe si jeni përgjigjur ju,
6 më dëgjoi me vëmendje. Pyetje nga Prokurori:

7 "A e dini nëse ka pasur kirurgë në spital?"

8 Ju jeni përgjigjur:

9 "Po, po. Ishte spital i qytetit, i kishin të gjithë
10 personelin mjekësor. Por nuk kishin të gjitha pajisjet që ju
11 nevojiteshin, sepse në atë kohë Shqipëria ka qenë në situatë
12 shumë të vështirë."

13 Tani pyetja ime është kjo, a e konfirmoni, z. Hoxha, se
14 në fakt kishte kirurgë, kishte kirurgë, e konfirmoni që kishte
15 kirurgë në spitalin e Kukësit në atë kohë në 1999?

16 PË. Po, me siguri që e konfirmoj, se ata të plagosur
17 faktikisht që kanë qenë me plagë prej arme, ata dikush i ka
18 operu, përpos kirurgu ata s'mund i operon askush.

19 PY. Kam një seri pyetjesh të shkurtra dhe besoj që do të mund
20 të ndalojmë pastaj për pushimin e drekës.

21 PY. Z. Hoxha, përveç atyre vendeve që përmende, Krumë, Cahan,
22 Kolsh, fshati i Selver Maçkajt, domethënë përveç këtyre, a ke
23 shku ndonji vend tjetër në Kukës që ke shku, por jashtë uzina
24 mekanike. Domethënë në Kukës brenda, por jashtë uzinës
25 mekanike të Kukësit?

1 PË. Brenda Kukësit normal, kam qarkullue. A jashtë Kukësit,
2 përpos qeto vende, faktikisht nuk kam qenë. Ama brenda Kukësit
3 normal që kam qarkullu.

4 PY. Flasim për zonën e Kukësit, jo jashtë Kukësit. Për çfarë
5 arsye dhe në cilat momente keni shku për çfarë rastesh keni
6 shku jashtë, keni dalë prej uzinës mekanike, keni shku në këto
7 vende?

8 PË. Po më ka ndodhë me pi ndonji kafe dikund, ka ndodhë me
9 dalë me hangër me ndonji shok ndonji dakrë. Ka pasë edhe asi
10 raste faktikisht. Ka ndodhë me shku me mbushë makinën me
11 derivate, na kemi qenë të lirë aty, qarkullimin e kemi pasë të
12 lirë, domethënë bile unë e kam pasë qarkullimin e lirë pa
13 ndërprerje. Nuk kam pasë kufizime.

14 PY. Këto rastet kur keni dalë prej uzinës së Kukësit, për
15 kafe, për darkë, a ka ndodhë çdo ditë kjo punë?

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
17 tha darkë, më duket.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Darkë me shokë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Apo
20 darkë qenka.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

22 PY. Në këto raste kur keni dalë, a keni dalë për çdo ditë,
23 për shembull, keni shku me pi kafe çdo ditë, a keni shku me
24 mbushë makinën me derivate çdo ditë, apo ka ndodhë ma rrallë?

25 PË. Jo, ajo ka ndodhë kohë pas kohe, se unë pa ndërprerje,

1 faktikisht, edhe nuk kam qenë, unë tregova, s'kam qenë unë në
2 Kukës pa ndërprerje. Kam qenë në Krumë, kam qenë në Cahan,
3 nuk kam pasë kohë pa ndërprerje me qenë unë aty. As me dalë në
4 qytet. Përndryshe ushqimin e kemi pasë në kazermë, jemi ushqy
5 në kazermë, jemi ushqy, pa ndërprerje. Me drekë, me darkë, me
6 mëngjes, me krejt i kemi pasë në kazermë. Në uzinë faktikisht.
7 PY. Në një intervistë me ZPS-në, z. Hoxha, keni përmendë një
8 rast konkret ku keni dalë për darkë jashtë, me shokët, a të
9 kujtohet?

10 PË. Po, më kujtohet shumë mirë bile. Ka qenë darka e vetme sa
11 kam qëndru në uzinë, ka qenë darka e vetme që kam dalë jashtë
12 uzinës me hangër darkë dikund.

13 PY. A ju kujtohet kur ka ndodhë kjo, drejt momentit të fundit
14 kur ke qëndru aty, kah mesit apo kur? Koha pak a shumë.

15 PË. Jo, s'më kujtohet. Jo, s'më kujtohet.

16 PY. S'prish punë. A ju kujtohet përafërsisht sa kohë keni
17 ndejtë jashtë për darkë me shokët atë natë?

18 PË. Nuk e di, dy orë, tri maksimumi. Qaty dy orëve.

19 PY. A ka, kjo darkë a ka qenë aty brenda në qytet të Kukësit
20 apo diku tjetër?

21 PË. Po, po. Në Kukës ka qenë. Në Kukës.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Gjykatëse, ndoshta ky
23 është momenti i duhur që të ndërpresim seancën dhe të
24 vazhdojmë mbas dreke.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Dëshmitar, tani do të bëjmë pushimin e drekës, dhe
3 vazhdojmë me pyetjet e Prokurorisë mbas pushimit.

4 Përpara se të bëjmë pushimin, desha t'ju informoj për
5 ndryshimet në orarin e punës sot mbasdite. Do të vazhdojmë në
6 orën 14.00. Kena pushim pak ma të shkurtër. Do të bajmë një
7 orë e gjysmë seancë, mandej dhjetë minuta pushim, edhe mandej
8 edhe një gjysmë ore shtesë. Domethënë, do mbarojmë në 16.10.
9 Pak ma gjatë se zakonisht. Dhe në fund kemi vetëm një seancë
10 30-minutëshe. Në rregull për të gjithë?

11 Seanca ndërpritet. Jo, jo -- është pak herët. Por duhet
12 të shoqërojmë dëshmitarin jashtë.

13 Shifemi në orën 14.00 z. Dëshmitar.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
16 është momenti që të ndërpres. Seanca ndërpritet.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.38

18 --- Seanca rifillon në orën 14.05

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
20 se vini! Ora 14.05.

21 Shoh Prokuroria ka të njëjtën përbërje.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Njëjtë.

23 Mbrojtësi i Viktimave në anën time të majtë.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Të njëjtën përbërje edhe ne.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Shala është me neve këtu i pranishëm.

2 Z. Shala, mund të konfirmoni që më dëgjoni.

3 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
5 mirë.

6 Vazhdojmë me marrjen në pyetje të z. Zijadin Hoxha nga
7 Prokuroria. Por përpara kësaj më informuan që Mbrojtja ka
8 paraqitur një kërkesë. Pyetja ime tani është: A mund ta
9 trajtojmë këtë në seancë publike apo duhet të preferoni që të
10 kalojmë në seancë private?

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Z. Aouini po merret me këtë
12 kërkesë.

13 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.
14 Faleminderit, z. Gilissen.

15 Ky diskutim ka të bëjë me rregullën 151. Nuk e di nëse ju
16 preferoni të kalojmë në seancë private për këtë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
18 ide e mirë që të kalojmë në seancë private, në fakt.

19 Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private, ju lutem.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit, znj. Sekretare. Znj. Punonjëse e Gjykatës në
10 qoftë se palët s'kanë asgjë tjetër për të paraqitur, atëherë
11 mund vazhdojmë me marrjen në pyetje nga ana e Prokurorisë, e
12 dëshmitarit.

13 Tani do vazhdojmë deri në 16.30 -- 15.30, pastaj bëjmë 10
14 minuta pushim edhe një gjysmë ore të fundit pastaj.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
17 se erdhët, z. Dëshmitar!

18 DËSHMITARI: Përshëndetje!

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
20 vazhdojmë tani me pyetjet që do t'ju parashtrojë Zyra e
21 Prokurorit të Specializuar. I njëjti Prokuror, pra, që ishte
22 gjatë -- përpara pushimit.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

24 PY. Mirë se vini, z. Hoxha! Uroj të keni pushuar gjatë
25 drekës.

1 PË. Po mirë, faleminderit.

2 PY. Përpara që të kaloj në temat e tjera, desha të kthehem
3 pak te dy pika që trajtuam pak shkurtimisht përpara pushimit
4 të drekës.

5 Sot dhe këtë mund ta gjejmë në faqen 57, rreshtat 24, 25
6 dhe faqja 58 dhe rreshti 1 deri në 4, biseduam për çështjet e
7 mjetet e përdorura për të transportuar kufomat e të vdekurve
8 apo të plagosurve nga fronti i luftës deri në Kukës, ju
9 kujtohet kjo pjesë e bisedës?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe pastaj kur ju bëra pyetjen për mjetet që janë përdor
12 për transportuar të plagosurit dhe të vdekurit, ju u
13 përgjigjët duke thënë:

14 "Nuk e di se s'kam qenë aty. Nuk mund t'ju jap përgjigje
15 për këtë".

16 Kjo ishte përgjigja juaj sot, për sa i përket mjeteve të
17 transportit.

18 Megjithatë, desha t'ju rikujtoj deklaratën që keni dhënë
19 ZPS-së që është 077857-TR-ET Pjesa 4 RED, faqja 6 dhe 7.

20 PY. Këtu jeni përgjigjur lidhur me mjete të transportit të
21 përdorura për plagosurit dhe të vdekurit nga -- vija e frontit
22 në Kukës. Përgjigja juaj ishte:

23 "Është përdorur kamioni për të transportuar -- ushtarët e
24 vrarë apo të plagosurit nga vija e frontit. Ka patur fasha që
25 janë vendosur apo janë trajtuar plagët gjatë transportit,

1 sepse deri në Krumë janë transportuar me automjete të tjera
2 pastaj nga Kruma në Kukës janë transportuar me këtë kamionin”.

3 Pra, në deklaratën që keni dhënë ZPS-së keni përmendur
4 qartësisht kamionë që kanë transportuar këta persona deri në
5 njëfarë vendi në Krumë, pastaj nga Kruma -- deri në Kukës me
6 kamion. A i qëndroni kësaj që janë përdorur këto mjete
7 transporti?

8 PË. Po prej vijës së frontit, faktikisht, unë nuk e di se në
9 vijë të frontit nuk kam qenë. Unë di që me atë kamionin që
10 është edhe në incizim me q'atë kamion i kanë pru prej Krume,
11 faktikisht, të plagosurit, prej Krume i kanë prue. E prej
12 frontit me çka i kanë tërhjek, faktikisht, deri në Krume unë
13 nuk e di se në front nuk kam qenë. Unë s'kam qenë në vijat e
14 frontit asnjëherë.

15 PY. Në qoftë se nuk e dini se si janë transportuar kufomat
16 nga vija e frontit, pse i keni thënë Prokurorisë që ata janë
17 transportuar me kamionçina ose me -- xhipa?

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
20 të bisedojmë, që ta trajtojmë këtë në prani të dëshmitarit apo
21 jo?

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Sepse ajo që -- lexojmë në
23 deklaratë -- në transkript lidhur me deklaratën e mëparshme
24 është diçka ndryshe. Ne duhet t'i japim mundësinë dëshmitarit
25 që të shohë deklaratën e mëparshme, sepse deri në Krumë -- po

1 jua le juve.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
3 që do bëjmë është do nxjerrim në ekran, sepse në qoftë se ka
4 diskutime lidhur me përmbajtjen e deklaratës, ashtu siç e
5 thamë përpara pushimit. Këto ish-in udhëzimet që dhashë më
6 herët, kështu që do të shfaqim në ekran deklaratat pastaj t'ju
7 jap fjalën.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta shfaqni në ekran këtë,
9 siç e thashë më parë, ky dokument është 007857-TR-ET Pjesa 4
10 RED, faqet 5, 6 -- 6, 7.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Vazhdoni, znj. Sekretare. E kemi versionin shqip?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Fatkeqësisht në këtë moment nuk
14 e kemi. E gjetëm këtë referencë gjatë pushimit. Për momentin
15 këtë kemi.

16 Ndoshta mund ta përmbledh këtë tek, të përqendrohëm tek
17 rreshtat e fundit, për sa i përket transportit të kufomave dhe
18 të plagosurve nga Kruma në Kukës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Pastaj e përkthejmë në shqip, si gjithmonë dhe mund të shohim
21 që bëhet e qartë.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Pika që po paraqes unë këtu është
23 nga transporti nga vija e frontit në Krumë që përmendet në
24 deklaratat e mëparshme. Ka të bëjë me pyetjen nëse janë
25 përdorur, është përdorur kamion apo -- Pra, qëndrimi jonë

1 është që kamioni apo kamionçina është përdorur nga Krume në
2 Kukës dhe jo nga vija e frontit në Krumë. Kjo ishte pika që
3 desha të qartësoj.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua
5 të them që nuk do duhej të kishim bërë këtë debat këtu, por
6 tani, në prani të dëshmitarit tani që është këtu.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do ta bëjmë shumë të shkurtër.
8 Përqendrohemi tek pjesa e transportit të kufomave dhe të
9 plagos -- të kufomave nga Kruma në Kukës.

10 PY. Deklarata e ZPS-së që kemi ne përpara nesh duket që nga
11 Kruma në Kukës trupat dhe të plagosurit janë transportuar me
12 kamion, nga Kruma në Kukës, a ka ndodhur kështu?

13 PË. Po është ai i njëjti kamion që është në incizim. Në
14 fillim të incizimit është i njëjti kamion. Aty duket,
15 faktikisht, duket gjaku, duken fashat, duken të gjitha. Janë
16 të gjithat të dhënat faktikisht në atë kamion që me atë kamion
17 janë transportu prej Krume në spitalin e Kukësit.

18 PY. Doja edhe një çështje tjetër që desha të sqaroj me juve.
19 Më herët biseduam për vendin ku janë dërguar kufomat e të
20 plagosurit dhe ju përmendët një vend që quhej Gorozhup. Në
21 faqen 57 rreshti 20, ju kujtohet ky emër Gorozhup?

22 PË. Po Gorozhupi më kujtohet si emër, faktikisht. Këtu unë
23 s'kam qenë kurrë në jetën time.

24 PY. Edhe nëse s'keni qenë atje vetë personalisht, a e dini ju
25 çka -- ka pas aty në Gorozhup? Sepse ju përmendët se të

1 vdekurit dhe të plagosurit janë transportuar në këtë vend.

2 Pra, pyetje ime është, a e dini çka ka pas aty në Gorozhup në
3 atë kohë?

4 PË. Faktikisht, në Gorozhup ka pas luftime, ballë për ballë
5 me shkije, ushtria jonë me ushtrinë serbe. Aty, faktikisht,
6 janë plagos të gjithë këta të plagosurit që kanë qenë në
7 spitalin e Kukësit, por edhe pesë kanë qenë të vrarë, në
8 Gorozhup. Gorozhupi është brenda në Kosovë. Ka qenë fronti i
9 luftës, faktikisht.

10 PY. A ka pas ndonjë vend të UÇK-së në Gorozhup në atë kohë?

11 PË. Po, faktikisht, këta ushtarë që janë vra janë vra në
12 Gorozhup. Ata aty kanë qenë se fronti është nis faktikisht
13 prej Shqipërie, prej kufinit është nis për me hi brenda në
14 Kosovë. Gorozhupi është brenda në Kosovë. Ajo ka qenë betejë,
15 faktikisht. Unë nuk kam qenë në atë pjesë, unë kam nejt në
16 këtë pjesën këtë onë, faktikisht. Kam qenë logjistikë. Nuk e
17 di atë pjesën; nuk e njoh. Po e di, faktikisht, në bazë të
18 komandantëve dhe në bazë të dhënave të gjithëve, faktikisht,
19 që kanë ra aty pesë dëshmorë kanë ra edhe gjashtë a shtatë
20 kanë qenë të plagosun në Gorozhup.

21 PY. Faleminderit për këtë sqarim, por pyetja ime ishte
22 ndryshe. Pyetja ime ishte, a ka pas ndonjë vend të UÇK-së, për
23 shembull, ndonjë qendër të UÇK-së, a ndonjë bazë të UÇK-së në
24 Gorozhup në atë kohë?

25 PË. S'di. S'di s'kam qenë unë atje.

1 PY. Këta të plagosurit që janë sjellë nga ai vend a kanë
2 bisedu ushtarët lidhur me këtë vend, a betejë apo vendin në
3 veçantë për çfarë bëhet fjalë, a e ka përmend ndoshta dikush
4 aty se çka kishte aty në Gorozhup, çka gjendej aty?

5 PË. Po faktikisht ne kemi bisedu me bashkëluftëtarët tonë që
6 kanë qenë në atë pjesë, faktikisht. Po aty kanë ra në pritë;
7 kanë qenë në depërtim e sipër, faktikisht, forcat tona dhe
8 kanë ra në pritë dhe q'aty janë vra pesë vetë, pesë --
9 dëshmorë na u kanë vra në Gorozhup, në të njëjtin vend.

10 PY. Kalojmë në një temë tjetër, z. Hoxha. Do t'ju bëj disa
11 pyetje lidhur me ambientet e uzinës mekanike në Kukës. Duke ju
12 bë këto pyetje do t'ju tregoj edhe fotografitë e këtij
13 kompleksi, ndërtesat pjesa më e madhe e tyre duket, kanë të
14 njëjtën paraqitje siç ishte në maj-qershor të '99. Megjithatë,
15 keni parasysh se disa prej tyre mund të jenë ndryshe, mund të
16 duken ndryshe.

17 Do filloj me disa pyetje lidhur me vendin ku keni punu ju
18 në uzinën mekanike në Kukës dhe ndërtesat e tjera në atë vend.

19 Së pari, t'ju tregoj një fotografi nga lart të kompleksit
20 dhe t'ju bëj disa pyetje.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, qëllimi
22 është që të bëjmë një përshkrim me dëshmitarin të kompleksit
23 nga një -- këndvështrim lehtësisht ndryshe. Pra, të fillojmë
24 me një fotografi nga ajri. Të shohim nëse dëshmitari
25 identifikon strukturat ose disa nga strukturat në kompleks.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Shohim së pari nëse dëshmitari e njeh, i identifikon këtë
3 struktura.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Natyrisht.

5 A mund të shfaqim në ekran dokumentin në vijim:

6 SPOE003303 [sipas përkthimit].

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, ju lutem, shfaqni dokumentin e kërkuar në ekran.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. Kështu mjafton.

10 PY. Z. Hoxha, e di që s'e keni parë këto struktura, këto

11 ndërtesa nga lart, nga ajri, por ndoshta do jeni në gjendje,
12 megjithatë, që të identifikoni disa prej këtyre vendeve.

13 Paraprakisht doja t'ju thoja që në këtë ndërtesë është një

14 ndërtesë që mungon, një strukturë që ka qenë atëherë dhe nuk

15 është tani dhe që gjendej në mes të oborrit. Pra, fotografia

16 nuk paraqet të njëjtat ndërtesa siç ishin në maj të '99-s; një
17 pjesë e këtyre ndërtesave është prishur.

18 Pra, duke parë këtë fotografi të bërë nga ajri, nga lart,

19 a jeni në gjendje të identifikoni në njërën nga -- prej këtyre

20 ndërtesave, është diçka, janë gjëra që i njihni këto ndërtesa?

21 PË. Po, një pjesë, po e njoh.

22 PY. Faleminderit. Tani hap pas hapi t'i marrim një nga një

23 këto ndërtesa që paraqiten në këtë fotografi dhe të shohim se

24 cilat janë këto ndërtesa.

25 A mund të identifikoni në këtë fotografi hyrjen në

1 kompleks, pra, hyrjen kryesore. Në qoftë se mund ta bëni këtë
2 gjë shënojeni me numër 1, ju lutem.

3 PË. [Shënon]

4 PY. Faleminderit.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'i
6 tregoj dëshmitarit. Përkrah kësaj fotografie që do doja të
7 ishte në ekran gjatë gjithë kohës të tregoja disa fotografi të
8 tjera të ambientit atje edhe do doja që të bëheshin shënime si
9 nga fotografitë me pamje nga ajri, por edhe fotografitë të
10 bëra nga terreni për vende të ndryshme.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sekretare...

14 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Seancës
15 këshillohen]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
17 zhduket shënimi në qoftë se duam ta ndryshojmë fotografinë.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po atëherë sikur ta bëjmë
19 kështu. E bëjmë më të vogël dhe më pas të tregojmë fotografitë
20 e tjera edhe dëshmitari mund të shënojë ku është hyrja në këtë
21 fotografi.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po a
23 e kuptoni që do të zhduket shënimi që kemi tani.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, po. S'ka gjë, e shënojmë
25 prapë. E shënojmë prapë. Nuk besoj se është problem.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull Sekretare atëherë. Zvogëlojeni këtë imazh dhe vendosni
3 përbri dokumentin që ju ka kërkuar Prokurori.

4 Përpara se të fillojmë, a mund ta pyesni dëshmitarin se
5 çfarë po sheh këtu. Se pyetja ime, pra, unë dua që ai të
6 identifikojë çfarë është kjo strukturë.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Patjetër.

8 PY. Z. Hoxha, a mund ta thoni për procesverbal çfarë është
9 struktura që shohim në fotografi?

10 PË. Faktikisht është uzina në Kukës.

11 PY. Uzina ku keni qenë ju në vitin 1999?

12 PË. Po, kjo është.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sekretare, a mund të vendosni
14 përbri këtij dokumenti -- dokumentin tjetër me numër
15 SPOE0010264 deri në 40010559, në faqen 11.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Vazhdoni, Sekretare.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

19 PY. Z. Hoxha, dje në gjykatë ju thatë, dhe kjo është
20 reflektuar në faqen 32 të transkriptit, thatë:

21 "Brenda kësaj depoje -- brenda kësaj depos kisha
22 tavolinën", the. Kështu keni thënë dje.

23 Pra, a e konfirmoni që në të majtë, te fotografia në të
24 majtë, në këtë pjesë të depos ju kishit tavolinën tuaj dhe
25 këtu punonit?

1 PË. Po, e konfirmoj.

2 PY. A mund të shohim tani fotografinë në të djathtë dhe të
3 shënoni edhe një herë me numër 1 hyrjen dhe me numër 2 depon
4 ku keni punuar në vitin '99?

5 PË. [Shënon]

6 PY. Faleminderit. Thjesht për sqarim, a është ky vendi me
7 numër 2 vendi ku punonit, ku riparoni armët në vitin '99?

8 PË. Po, faktikisht kjo ka qenë depoja kryesore.

9 PY. Dje gjatë dëshmisë suaj ju thatë diçka që është
10 reflektuar në faqen 33, rreshtat 10 e 13 të transkriptit dhe
11 thatë se kishte raste që armët i riparoni jashtë depon dhe
12 thatë si në vijim:

13 "Kur kishte nevojë apo defekt të madh, në një riparim të
14 madh që duhet ta bëja unë punoja jashtë në oborr...".

15 Kështu është? Është e saktë?

16 PË. E saktë.

17 PY. Te fotografia nga ajri, që është në të djathtë, me
18 përfaqësi, a mund të shënoni vendin kur riparoni armët në
19 oborr dhe vendosni numrin 3?

20 PË. [Shënon]

21 PY. Procesverbal, a ka qenë përpara hyrjes -- ka qenë përpara
22 portës ku hyje dhe dilej nga depoja apo ka qenë ndonjë vend
23 tjetër?

24 PË. Ka qenë, faktikisht, anash. Anash hymjes, faktikisht, ka
25 qenë. Vinçi ku është te vinçi aty faktikisht. Ku shihet në

1 fotografi në anën e majtë ku shihet vinçi i madh aty te vinçi
2 faktikisht kam punu.

3 PY. E keni fjalën për këtë -- këtë pikën nga numri 2, këtë
4 vizën e zezë, domethënë, është një si vizë e zezë, për këtë
5 vendin e keni fjalën?

6 PË. Bash aty.

7 PY. Z. Hoxha, te kjo depoja ky punonit ju, a ndodhte
8 ndonjëherë që dhe të flinit aty?

9 PË. Po, më ka ndodhë nja dy net më ka ndodh. Jo dy net në
10 zgjim faktikisht po një herë kam fjet një natë, një herë kam
11 fjet një natë, por jo në këtë pjesën ku kam punur. Kam fjet në
12 anën e kundërt, faktikisht, në anën e majtë, nga hymja
13 kryesore në anën e majtë.

14 PY. A mund ta shënoni me A, me germën A vendin ku flinit?

15 PË. A te fotografia në anë të majtë apo në anë të djathtë?

16 PY. Te fotografia me pamje -- nga ajri, ajo në të djathtë.

17 PË. Me numër 4, a?

18 PY. Jo, jo, shkronjën, shkronjën A, me shkronjën A.

19 PË. [Shënon]

20 PY. Ju thatë që flinit atje. Keni fjetur atje 2 net. Thatë
21 nja dy net.

22 Ka qenë ky i vetmi vend? Numrin A --

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

24 mund ta sqarojë me këtë kur tha "ka fjet disa net atje". Të na
25 thotë sa net saktë. Ju lutemi pyeteni konkretisht sa net ka

1 fjetur dhe pastaj do të bëj një koment.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po do ta bëj këtë pyetje.

3 Z. AOUBINI: [Përkthim] Para se të bëni këtë pyetje, të
4 nderuar Gjykatës.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
6 përfundojmë me këtë sepse fjala e përdorur në anglisht është e
7 paqartë.

8 Z. AOUBINI: [Përkthim] Po dëshmitari bëri korrigjimin
9 vetë. Mund ta lexoni. Do ju jap unë edhe rreshtin e saktë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 [Mikrofoni çaktivizuar]

12 Z. AOUBINI: [Përkthim] Në faqen 82, rreshti 21 dhe 22 ai
13 tha vetë. E tha, e tha. E ka thënë dy net, e ka thënë
14 konkretisht -- specifikisht.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 [Mikrofoni çaktivizuar]

17 Po. Po faleminderit, Avokat.

18 Prokuror, fjala është për ju.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

20 PY. Z. Dëshmitar, kemi nevojë të sqarojmë dhe një herë këtë
21 punën sa net keni fjetur në depo. Sepse fillimisht kemi, keni
22 përdorur një fjalë që keni thënë:

23 "Kam fjetë nja dy net".

24 Pastaj keni thënë:

25 "Dy net".

1 Konkretisht sa net keni fjetur në depon -- në uzinën
2 mekanike në Kukës në vitin 1999? Pra, sa net keni fjetur
3 konkretisht?

4 PË. Dy net kam flejt.

5 PY. Dua t'ju tregoj një fotografi tjetër.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem, heqim fotografinë që
7 është në të majtë, por fotografia me pamje nga ajri do të
8 mbetet në ekran siç është. Ju lutem, të përdorim të njëjtin
9 varg numrash që ju thashë më herët që është SPOE40010264...

10 Po. Ju lutem, të vendoset në të majtë të ekranit i njëjti
11 dokument me të njëjtën varg numrash SPOE001624 [sipas
12 përkthimit] deri në 40010559, por këtë herë do doja që të
13 vendosnit faqen 165.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 lutem, përdorni mikrofonin.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

20 PY. A e njihni këtë strukturën që shohim te fotografia në të
21 majtë?

22 PË. Jo, nuk e njoh.

23 PY. Z. Hoxha, sot në faqen 41 të transkriptit në rreshtin 15
24 është reflektuar që ju keni thënë që brenda uzinës mekanike
25 ishte një depo e vogël.

1 "Kisha çelësat edhe i vendosja atje".

2 Pra, ka pasur në depo brenda, depo të vogël -- më falni -
3 - brenda uzinës. A është kjo ajo depoja që përmendët ju sot në
4 dëshminë tuaj, kur thatë ajo depoja e vogël mos është kjo
5 këtu? Depoja e vogël brenda uzinës?

6 Z. AOUINI: [Përkthim] Prisni një çast.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Avokat, po.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Ai tha "brenda uzinës" dhe ai tani
10 po e pyet brenda depos. Ka depo brenda uzinës --

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do ta sqaroj unë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 rregull. E morëm parasysht.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

15 PY. Në dëshminë që ju lexova ju thatë që ishte një vend, një
16 ambient brenda uzinës, nuk e specifikove tamam. Edhe thatë që
17 në atë vend vendosja armët që riparoja. Ku ishte kjo struktura
18 që thatë ju? Ju thatë "një depo e vogël brenda uzinës". Ku
19 ishte?

20 PË. Po nuk është kjo depo, nuk është kjo depo, faktikisht.
21 Për depon që kam mendu unë, faktikisht, edhe kur e kam pa si
22 depo që e kam pas të armatimit ka qenë në dhomën ku kemi
23 flejt, përballë korridorit ka qenë, faktikisht. Ka qenë një
24 dhomë e vogël. Aty brenda, faktikisht, ku ka qenë Shtabi i
25 Përgjithshëm, ku ka qenë udhëheqësia e Shtabit, faktikisht,

1 aty e kam pas një pjesë të vogël aty i kam vendos armët. Këto,
2 kjo s'më kujtohet. Mundet me ndodh që ka qenë e mbulume me
3 tesha me mall nuk e di, por nuk po më kujtohet si strukturë që
4 kjo, as që e kam pa asnjëherë.

5 PY. Dua --

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Prokuror, dua të them edhe unë diçka. Herën tjetër për të
8 gjitha pyetjet që do të bëni, bëni pyetje të hapura. Sepse
9 këtu mund ta kishit pyetur edhe të thonit, a mund të na thoni
10 ku ndodhej kjo depo. Në vend që t'i thonit, a është kjo
11 depoja?

12 Dhe dua të flas edhe për një pikë tjetër. I gjithë
13 qëllimi i fotografisë në të djathtë, edhe këtë fotografi e
14 kemi pasur të redaktuar ne donim që dëshmitari të
15 identifikonte fillimisht ambientin, po ju filluat direkt dhe i
16 thatë, ja ky është ambienti.

17 Tani nuk kthehemi dot më mbrapa në kohë, por ju lutem
18 respektoni udhëzimet e Trupit Gjykses, sepse deri tani paskan
19 qenë të kota. Dhe bëni pyetje të hapura që të zbulojmë informa
20 -- të shohim çfarë informacioni do të na japë dëshmitari.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, do përpiqem ta respektoj
22 udhëzimin tuaj.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Vazhdoni tani.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 PY. Z. Hoxha, dua të përmend shkurtimisht deklaratën që i
2 keni dhënë ZPS-së është me numër 077857-TR-ET Pjesa 4 RED,
3 faqja 29. Kur ju bën pyetje për vendin ku magazinonit armët ju
4 thatë kështu:

5 "Ishte një mjedis i vogël që dikur kishte qenë banjo. Aty
6 kisha vendos një si strukturë; kisha krijuar një strukturë për
7 të vendosur armët, si një lloj depoje. Dhe më pas i merrja
8 armët edhe i dërgoja atje ku nevojiteshin".

9 Tani pyetja ime është kjo: Ju keni thënë një depo; ju
10 thatë ishte një depo ku vendosnit armët. Kjo struktura në të
11 majtë, a ishte kjo, a bëhet fjalë për strukturën në të majtë?
12 PË. Është krejt tjetër ndërtesë ajo, faktikisht. Ajo depo ku
13 kam pas unë është krejt tjetër ndërtesë. Është ndërtesa
14 faktikisht te dhoma ku kam fjet menjëherë përballë dhomës ku
15 kam flejt. Si hapsha derën e dhomës ku ka flejt, faktikisht,
16 menjëherë në ballë ka qenë ajo depo e vogël.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Avokat, shoh që u çuat në këmbë.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Dhe ju kërkoj ndjesë që po ju
20 ndërpres sërish.

21 Pyetja e kësaj depos u bë një herë, u mor përgjigja, nuk
22 është nevoja që të përsëritet se po shohim që po ushtrohet pak
23 trysni. Po ne ashtu, ne duam të përcaktojmë për çfarë
24 strukture bëhet fjalë. Përpara se t'i referohet Prokurori
25 deklaratës së mëhershme të flasim një herë për cilën strukturë

1 bëhet fjalë; të vendoset një numër dhe më pas të flasim në
2 cilin vend ishte dhe pastaj a të -- sqarojmë se për cilin për
3 cilën pjesë të uzinës, në cilën pjesë ka qenë kjo depo. Ne i
4 treguam një fotografi, ai nuk e njohu dhe më pas i përsëritet
5 e njëjta pyetje dhe përgjigja e tij ishte për një pjesë
6 tjetër. Ai tha është një pjesë tjetër e ndërtesës.

7 Pra, në qoftë se ka ndonjë strukturë tjetër që ai ka
8 krijuar dhe do na e shpjegojë dëshmitari se në cilin vend
9 paska qenë kjo strukturë.

10 Ky është kundërshtimi im.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Prokuror, doni të kundërpërgjigjeni?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, e kemi sqaruar gjërat që
14 kishim nevojë -- për të cilat kishim sqarim. E sqaroi edhe
15 dëshmitari, tha që ishte një vend tjetër dhe po e le për
16 momentin.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vetëm
18 ta keni parasysh për herën tjetër. Ne nuk nxjerrim në ekran
19 një pjesë të deklaratës për ta ballafaquar. Por e kuptova që
20 në këtë rast ju e gjykuat të nevojshme.

21 Vazhdoni tani.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

23 PY. Z. Hoxha, dje thatë -- në faqen 25 rreshtat 8 dhe 9 dhe
24 13, 14, ju thatë që ishte dhe një ambient saniteti brenda
25 uzinës, kështu? Ishte një zyrë saniteti brenda uzinës, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Nëse është e mundur te fotografa nga ajri që është në të
3 djathtë mund ta shënoni me numrin 4, në qoftë se mundeni. Në
4 qoftë se mund ta gjeni se ku është në fotografi.

5 PË. [Shënon]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Dëshmitar e shënuat? A e shënuat?

8 DËSHMITARI: Po e shënova por më duket --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se
10 nuk ka dalë në ekran. Të paktën Trupi Gjykues nuk arrin ta
11 shohë. Faleminderit.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 PY. Kur po flisnit për këtë zyrën e sanitetit në uzinën
14 mekanike të Kukësit, në faqen 20, rreshtat 8 deri në 10 ju
15 keni thënë:

16 "Ishin dy a tri vajza që qëndronin atje".

17 Kush ishin këto dy a tri vajza?

18 PË. Faktikisht, kanë qenë ushtarë. Nuk i njoh me emër.

19 PY. Ju, në fakt, jeni përgjegjgur në kuadër të kësaj zyrës së
20 sanitetit. Këto dy-tri vajzat a mos ishin personel mjekësor
21 apo jo?

22 PË. Faktikisht, personel mjekësor kanë qenë me siguri e kanë
23 pas edhe shkollën e mjekësisë e kanë pas të kryme. Kam qenë
24 edhe unë një herë te këto vajzat. Kam pas një rast e kam pas
25 edhe në njëfarë mënyre ma ka dhënë ndihmën e parë edhe që aq.

1 PY. Por ato, këta persona që të dhanë ndihmën e parë, çfarë
2 ishin? Ishin doktorë, ishin motra medicinale, a ishin anëtarë
3 të tjerë të personelit mjekësor? Pra, kush ishin?

4 PË. Kanë qenë motra medicinale kanë qenë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Prokuror, a mund ta heqim fotografinë në të majtë?

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, fotografinë në të majtë
8 mund ta hiqni.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
10 lutem, Sekretare, hiqeni nga ekрани.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

12 PY. Gjatë kohës që punonit në uzinën mekanike të Kukësit, ku
13 nëse do kishit nevojë të shkonit në tualet, ku shkonit aty?

14 PË. Për besë nuk më kujtohet, s'më kujtohet ku. Nuk më
15 kujtohet. S'mund me dhënë përgjigje.

16 PY. Po a ka qenë brenda uzinës apo jo?

17 PË. Po me siguri që tualet ka pas brenda uzinës por s'më
18 kujtohet në cilën, cilin vend se unë më shumë kam qenë
19 faktikisht në lëvizje, sesa që kam nejt brenda në uzinë. Ne
20 kemi pas vende jo nëpër kafene, jo ku kemi mujt. Nuk më
21 kujtohet brenda në uzinë nuk më kujtohet. Më duket këtu te
22 komanda ka qenë një WC e vogël, por nuk jam i sigurt.

23 PY. Z. Hoxha, ne kemi në fakt dëgjuar dëshmi që ka pasur një
24 WC brenda uzinës mekanike të Kukësit, por nëse shohim këtë
25 vendin këtu; po e marrim si pikë referencë depo numër 2, shko

1 në anën tjetër. Dhe vazhdoje drejt dhe WC-ja ka qenë në fund
2 fare të ndërtesës në një korridor të gushtë. Kështu është
3 thënë në dëshmi.

4 A ju kujtohet, pra, që ka pasur WC aty?

5 PË. Jo s'më kujtohet, më fal. Nuk më kujtohet.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

7 Dëshmitar, ju kujtohet vetëm që duhet të thoni të vërtetën. Ju
8 rikujtoj që duhet të thoni të vërtetën. Keni qëndruar gjashtë
9 javë atje, nëse nuk e dini ne e pranojmë. Por nga ana tjetër
10 doja thjesht t'ju bëja këtë kujtesë.

11 DËSHMITARI: Edhe unë ju them -- të vërtetën. Për të
12 vërtetën kam ardhë këtu; nuk kam ardhë me gënjje.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

14 Prokuror, vazhdoni.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

16 PY. Kam edhe një pyetje tjetër. Ju keni qëndruar disa ditë në
17 uzinën mekanike të Kukësit dhe e kuptojmë që ju merreshit me
18 riparimin e armëve dhe nëse do të përdornit tualetin brenda
19 uzinës i takon që shkonit shpesh në tualet. Prandaj jam pak i
20 befasuar që ju nuk mund të na thoni as në përgjithësi se ku ka
21 qenë kjo WC, nëse shkonit atje çdo ditë.

22 Pra, Dëshmitar, çfarë mund të na thoni në lidhje me këtë?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Prokuror, Avokati është çuar në këmbë.

25 Le t'ia japim atij fillimisht fjalën.

1 Vazhdoni.

2 Z. AOUIINI: [Përkthim] Ne e kuptojmë rëndësinë e kësaj
3 çështje. Por kolegu im i nderuar nuk i bëri pyetje, por
4 komentoj. Dhe kjo nuk është e vërtetë. Dëshmitari është
5 përpjekur edhe tha që ka qenë një WC diku.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Rrëzohet. Nuk do ta diskutojmë më këtë temë.

8 Prokuror, vazhdoni.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

10 PY. Cili është qëndrimi juaj përfundimtar, Dëshmitar? Nuk ju
11 kujtohet ku ka qenë WC-ja, ndonëse ju e përdornit?

12 PË. Jo, s'më kujtohet se edhe armët faktikisht ku e kam pas
13 depon e armëve që i kam riparuar, faktikisht, edhe aty ka pas
14 WC. Edhe aty ka pas WC jo vetëm ku po thoni ju atje në qosh,
15 por edhe aty ku i kam mbajtur armët e riparume që i kam riparuar
16 armët edhe aty kanë qenë WC, faktikisht. Edhe sot me -- shku
17 në atë objekt, faktikisht, janë aty WC-të që aty në të njëjtin
18 vend janë.

19 PY. Ju thatë vetë që ka qenë një WC diku në qoshe. A nuk e
20 thatë?

21 PË. Po e thashë.

22 PY. Z. Hoxha, shohim dhe një herë fotografinë nga ajri.

23 Shohim që lart -- më fal -- në fund të fotografisë, në fund të
24 oborrit është një ndërtesë e shkurtër, e shihni atë? Nëse nga
25 numri 3 lart, vazhdon lart, është një strukturë. A e shihni që

1 është një strukturë?

2 PË. Po tan e shoh. Por unë edhe dje shpjegova, ku është numri
3 3 aty kanë qenë faktikisht të parkum tre ose katër kamionë me
4 defekte. Nuk jam i sigurt a kanë qenë tre apo katër. Ajo pjesë
5 e oborrit anejna nuk është pa se çka ka. Unë për vete nuk e
6 kam pa se s'kam pas detyrë kurrfarë detyre, kurrfarë obligimi
7 s'ka pas me shku në atë pjesë. Unë e kam pas faktikisht prej
8 Shtabit të Përgjithshëm në uzinë; prej uzine faktikisht kam
9 dalë në qytet ose kam shku diku tjetër. Kjo ka qenë relacioni
10 jem; nuk ka qenë relacioni jem me shëtit nëpër uzinë çka ka,
11 te ka.

12 Edhe plus në tjetrën anë kanë kalu 24 vjet. Normal që
13 s'mundesh me i mbajt mend të gjitha.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
15 Prokuror, për arsye qartësie do doja që ose me ndonjë numër
16 ose me ndonjë kryq të vendoset struktura për të cilën po
17 diskutojmë që të jemi të gjithë të qartë që po flasim për të
18 njëjtën ndërtesë.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Fatkeqësisht unë nuk e shënoj
20 dot për dëshmitarin, por mund ta udhëzoj dëshmitarin se si ta
21 shënojë.

22 PY. Z. Hoxha, ju lutem, shënoni ndërtesën për të cilën po
23 diskutojmë që ta kuptojmë të gjithë për cilën strukturë po
24 flasim.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Dëshmitar, pikë së pari, përgjigjuni pyetjes së Prokurorit dhe
2 më pas do ju jap fjalën. Dhe mund të thoni çfarë gjykoni që
3 është e nevojshme për të thënë. Në rregull? Faleminderit.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

5 PY. Pra, z. Hoxha, nëse është e mundur me numrin 5, a mund të
6 shënoni strukturën për të cilën ne po diskutojmë tani? Nga
7 numri 3 lart, vazhdo lart për nga oborri, në fund fare, në
8 fund të oborrit. Dhe unë për këtë strukturë e kisha fjalën,
9 shumë faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

11 Dëshmitar, deshët të thonit diçka? Flisni.

12 DËSHMITARI: Znj. Gjyqtare, desha me thonë diçka. Unë të
13 premtën kur e kam marrë dosjen time për me e lexu që e kam
14 dhënë intervjun në 2000 faktikisht, në shtator të vitit 2000,
15 në fund të dosjes time kanë qenë dy fotografi që asnjëherë, as
16 m'i ka tregu Prokuroria ose kurrkush hiç. -- Ato fotografi unë
17 nuk i njoh se çfarë fotografish janë tek janë. Kanë qenë dy
18 fotografi që nuk i njoh; nuk i kam pa asnjëherë nuk i kam pa.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
20 do të merremi me këtë tani, por faleminderit që na dhatë këtë
21 informacion. E kemi shënuar.

22 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

24 PY. Z. Hoxha, desha të bisedoj me juve për këtë strukturën që
25 shënuat me numër 5. Dhe që të jem i drejtë me ju duhet t'ju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Michalczuk

Faqe 99

1 them që kjo fotografi që po shihni tani nuk i paraqet
2 ndërtesat tamam siç janë duk në '99. Kjo strukturë që është
3 numër 5 ka qenë më gjatë, e futej më shumë në oborr. Pra, deri
4 në mes të oborrit.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në qoftë se mund të vendosim
6 një fotografi tjetër krahas kësaj fotografie, fotografi tjetër
7 e bërë nga ajri dhe t'i tregoj dëshmitarit një pjesë të kësaj
8 strukture nga një kënd tjetër ndryshe. Besoj që këtë fotografi
9 e kemi parë edhe dje.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jepni
11 referencën e dokumentit Sekretares, ju lutem.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është -- dokumenti mban numrin
13 SPOE40010264 deri në 40010559.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
15 Sekretare, ju lutem, shfaqni dokumentin e kërkuar.

16 A mund të na jepni numrin e faqes?

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Natyrisht. Numri është 19.
18 Faleminderit shumë.

19 Përpara që të bëj pyetjen, a mund ta zmadhoni deri në 150
20 për qind këtë ndërtesën, pjesën e strukturës që është e lyer
21 me të bardhë, që është e gëlqerosur. Zmadhojeni pak më shumë
22 ndoshta deri në 200 për qind që dëshmitari të ketë mundësi ta
23 shohë këtë ndërtesë nga afër. Kaq mjafton.

24 PY. E shihni këtë ndërtesë, z. Dëshmitar, me muret e lyera me
25 të bardhë atje në fund?

1 PË. Po e shoh, faktikisht, e kam pa edhe dje e kam pa, por ju
2 tregova edhe dje ju tregova edhe pak para ju tregova që,
3 faktikisht, që këtë pjesë nuk, unë për vete nuk mund me e pa
4 prej kamionëve që kanë qenë, kamionëve e parkum. Kamionët me
5 defekte që kanë qenë, këtë strukturë nuk e kam pa. Edhe dje e
6 kam cek, edhe pak pare e ceka. Kanë qenë kamionë, tre kamionë
7 ose katër, nuk e di, s'më kujtohet saktësisht.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Dëshmitar, nuk iu është bërë akoma pyetja. Ne e dëgjuam shumë
10 mirë këtë që thatë tani edhe atë që keni thënë dje. Mënyra se
11 si funksionon është që Prokurori nuk do t'i përsërisë pyetjen
12 që ju ka bë më herët, por ma merr mendja që do ketë pyetje
13 shtesë lidhur me këtë çështje. Në rregull?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Pyetja ime është: E dalloni qartë këtë ndërtesë dhe për
16 sa i përket vendndodhjes, ndërtesës që shënuat me 5, a
17 përputhet kjo me atë ndërtesë që shënuat me 5?

18 PË. Po në bazë të fotografisë prej ajri mundet me ndodhë. Nuk
19 jam i sigurt. S'jam i sigurt.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do doja t'i tregoj dëshmitarit
21 një fotografi tjetër të njëjtin vend nga një kënd tjetër. I
22 njëjti numër, faqja 27.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
24 Sekretare, ju lutem, shfaqni dokumentin.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 PY. Kjo është e njëjta ndërtesë e fotografuar nga një
2 distancë e afërt, më e afërt. Pra, kështu duket sot kjo
3 ndërtesë. Në anën e djathtë -- në anën e majtë, në qoftë se e
4 shohim këtë ndërtesë pak në të djathtë është një lloj, një
5 derë dhe një këmishë e varur aty, a e shihni?

6 PË. Këmishë nuk vërej.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
8 Trupin Gjykses nuk është e qartë se cilës derë i referoheni
9 ju, për cilën e keni fjalën, z. Prokuror?

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kemi ndërtesën në anën,
11 përballë nesh, në anën e majtë të fotografisë dhe pastaj në
12 anën e djathtë kur shohim këto murin me tulla të kuqe, në anën
13 e djathtë të tij kemi këtë si rroba që është varur aty. Është
14 në fund fare, në cep fare të fotografisë. Është si një lloj
15 korridorit aty dhe që besojmë që është porta që do të tregojmë
16 pas pak.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 përmendët një derë.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ne besojmë që është derë
20 hekuri.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Vazhdoni. Ju sugjeroj që t'i kërkonit dëshmitarit që të -- në
23 fotografinë e majtë të shënojë objektin për të cilin po
24 flisni, që të jemi të sigurt që po flasim për të njëjtën gjë.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Natyrisht.

1 PY. Z. Dëshmitar, shikojeni edhe një herë këtë ndërtesë. E
2 shihni murin me tulla të kuqe dhe në fund në të djathtë mund
3 të shihni një se si rroba, si tesha dhe një formë
4 drejtkëndëshe dhe që besojmë është dera, porta. Do jua
5 tregojmë kur të japim fotografinë më afër, por a mund ta
6 shënoni këtë fillimisht, këtë pjesën që është në formë
7 drejtkëndëshi me numrin 5A, që të jemi të sigurt që po flasim
8 për të njëjtën gjë.

9 PË. [Shënon]

10 PY. Faleminderit. Kjo është saktësisht pjesa për të cilën po
11 flasim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Konkretisht aty ku është vendosur shkronja A, thatë që është
14 një bluzë apo majicë apo diçka që është varur aty.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, për këtë po flas.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Përpara se të vazhdoni më tej, nuk jeni në këmbë por po lexoj
18 shprehjen tuaj të fytyrës dhe dua t'i jap Mbrojtjes gjithë
19 hapësirën e nevojshme për të shprehur lirshëm dhe po ua jap
20 fjalën edhe pa e kërkuar.

21 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit. Hezitojmë që të
22 ndërpresin seancën por në qoftë se fokusi është -- kjo
23 këmisha, po pse nuk u përmend në fotografinë e mëparshme,
24 sepse është shumë më e qartë aty. Në faqen paraprake është mu
25 përballë derës.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
2 që shoh unë këtu është që Prokurori po na bën një sqarim të
3 mënyrës sipas një rendi.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në fillim po tregoj këtë nga
5 vendi -- nga një distancë, pastaj pak nga pak duke iu afruar
6 ndërtesës, pjesa e derës dhe kjo këtu kjo këmisha që ishte
7 varur. Pastaj do doja që të në vijim të ndërhyrjes së kolegut
8 tim të kalojmë në faqen 26 të të njëjtit dokument për të pa se
9 si duket.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
11 në një moment apo tjetër do të duhet që t'i ruajmë -- ta
12 ruajmë këtë dokument.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Seancës
15 këshillohen]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
17 Prokuror, a mbaruat me këtë fotografi apo keni akoma punë me
18 të?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me fotografinë në anën e majtë
20 të ekranit kemi mbaruar.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Atëherë do të ruajmë dokumentin fotografinë në anën e majtë,
23 por jo të dyja.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Vetëm atë në të majtë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

1 Sekretare, ruani dokumentin, fotografinë në anën e majtë të
2 ekranit dhe jepi një numër prove.

3 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga
5 Dëshmitari W03887 në dokumentin me ERN SPOE40010290 do të
6 regjistrohet si provë me numër REG00993.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Prokuror, mund të vazhdoni. Faleminderit, znj. Sekretare.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Tani të shfaqim në anën e majtë
10 të ekranit dokumentin, fotografinë nga faqja 26.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

14 PY. Z. Hoxha, kjo është fotografi që paraqet vendin në një --
15 mënyrë më të qartë. A e shihni aty në fund derën e metalit dhe
16 këto rroba, këmishë apo çfarë është kjo që është varur aty, a
17 e shihni?

18 PË. Po, e shoh.

19 PY. Kur ishit në Kukës në '99, a ke hyrë ndonjëherë përmes
20 kësaj dere në strukturën apo strukturat e këtyre ndërtesave?

21 PË. Për mua, për vitin '99, ky ambient, faktikisht, është i
22 panjoftun. S'kam kalu asnjëherë kësajde.

23 PY. Z. Hoxha, ne kemi marrë dëshmi se në këtë vend ishte edhe
24 hyrja për në tualet, në banjo. E biseduam këtë çështje sot dhe
25 thatë që keni shku në tualet në '99 gjatë kohës që keni qenë

1 aty, a ju kujtohet që ka pas aty tualet, banjo?

2 PË. Nuk, s'më kujtohet. Po them është ambient i panjofshëm
3 për mua. Nuk e njoh.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Duam tani të tregojmë
5 strukturën siç ne e mendojmë ishte në '99 dhe për të bërë këtë
6 do heqim fotografinë në anën e majtë të ekranit dhe ta
7 zëvendësojmë me një fotografi tjetër me lejen tuaj, znj.
8 Gjykatëse.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
10 Prokuror, jepni numrin e referencës znj. Sekretare.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] P00093. E kemi ruajtur edhe në
12 074390 deri në 074391.

13 Në qoftë se mund të kthehemi shkurtimisht te fotografia
14 paraprake që të bëjmë një pyetje të fundit, ju lutem.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'ka
16 nevojë të kërkon ndjesë.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faqja 26 për atë që dhashë më
18 herët

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Desha
20 të konfirmoj me Sekretaren që mori, që ka referencën akoma aty
21 të fotografisë së mëparshme, pra.

22 Znj. Sekretare, ju lutemi, shfaqeni përsëri dokumentin.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, vazhdoj të përpigem që të zgjoj kujtesën për
25 vendndodhjen, vendet që janë aty dhe dua që t'i kushtoni

1 vëmendje këtyre tullave të kuqe që janë në anën e majtë. Pjesa
2 më e madhe e këtyre strukturave janë -- që mund të shihen aty
3 kanë -- tulla të kuqe. A ju ndihmon kjo që t'ju kujtohet apo
4 akoma jeni, për ju është e panjohur si zonë, si pjesë?
5 PË. Është e panjohur për -- si pjesë për mua është e
6 panjohur.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta heqim
8 këtë dhe ta zëvendësojmë me një dokument tjetër P00093 ose
9 074390 deri në 074391. Është i njëjti me ERN të ndryshme.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
11 Sekretare, ju lutem, nxirrni në ekran dokumentin e kërkuar. Z.
12 Prokuror, kërkoj një çast.

13 Z. Shala?

14 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka,
16 doni të thoni diçka? Se pata përshtypjen, më lejoni ta mbaroj
17 një herë, ju lutem. Pata përshtypjen që ju ishit pak -- nuk ju
18 pëlqeu kjo, a ka diçka, -- terezi, a kishit, a ka diçka që
19 duhet të kujdesemi?

20 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po, znj. Gjyqtare, se
21 Prokurori është për ta paraqit lëndën, por jo për të
22 inskrimue se nuk është tuj bë skenar filmi. E kthen tri herë
23 dëshmitarin, i tha për mua është e panjohur, nuk e njoh. Dje
24 ka thonë, ka qenë [e pakuptueshme] nuk ka pas [e pakuptueshme]
25 që ka pas çelësat pronari i shtëpisë, prapë të njëjtën gjë e

1 qet, jo këmisha, jo skenarë për -- skripta të filmave
2 vizatimorë po kon tuj bo. Kjo është një Gjykatë me [e
3 pakuptueshme] botërore, nuk është, këtu nuk jemi skenarë
4 filmash me bo. Kaq pata. Ju falënderoj.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Shala, kjo që thoni ju nuk qëndron hiç. Kështu që ju lutem
7 kini kujdes kur e thoni në këtë mënyrë ose që e thatë ju. Neve
8 ja, Trupi Gjygues e konsideron këtë relevante, pyetje, këto
9 pyetjet që bohen. Kështu që në qoftë se neve na duken të
10 rëndësishme dhe relevante si pyetje vazhdojmë në këtë mënyrë.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare shoh që nuk
12 është 100 për qind e zmadhuar fotografia. A mund ta bëni më të
13 madhe? Dhe të përqendrohemi te pjesa e fotografisë ku
14 paraqitet ndërtesa afër. Ndoshta kështu mjafton. Faleminderit
15 shumë. Kështu është mirë.

16 PY. Z. Hoxha, kjo është ndërtesa që ne mendojmë duket e
17 njëjtë edhe në '99 në uzinën mekanike në Kukës. A e shihni
18 atje në fund fare atë derën e hekurit që ju tregova më herët
19 në fotografinë paraprake?

20 PË. Unë po e shoh këtë fotografi. Faktikisht, edhe pare e
21 ceka më herët; unë të premtën kur ma keni dhënë dosjen është
22 hera e parë që e kam pa këtë fotografi. As s'mu ka prezantu
23 vitin 2000 as kurrë këtë fotografi parë nuk e kam njeh në
24 jetën time.

25 PY. A e shihni derën që u tregova fotografinë paraprake në

1 këtë fotografi?

2 PË. Është fotografi e panjoftun për mua; objekt i panjoftun
3 faktikisht. Nuk e kam pa kurrë asnjëherë në jetën time.

4 PY. E thatë këtë edhe më herët, por pyetja ime është ndryshe:
5 në këtë fotografi që e keni përpara jush tani, a shihni në
6 fund këtë derën që ju tregova në fotografinë paraprake, a e
7 shihni apo jo?

8 PË. Jo nuk e shoh se zi është. Nuk e shoh.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund ta zmadhojmë ndoshta
10 fotografinë, ndoshta 200 për qind që të dallojmë këtë derën.

11 PY. A e sheh këtë formë drejtkëndëshi, për të cilën folëm më
12 parë?

13 PË. Po, tani e shoh.

14 PY. Në fund fare a i shihni këto tulla që janë si të kuqe,
15 shumë afër derës?

16 PË. Po.

17 PY. Gjatë dëshmisë tuaj dje, z. Dëshmitar, dhe këtu po i
18 referohem faqes 33, rreshtat 10, 13 dëshmuat që përveçse keni
19 punuar brenda në depo keni punu edhe në oborr, saktë?

20 PË. Po.

21 PY. Keni punu në oborr. Kjo ndërtesë që shihet në anën e
22 majtë të fotografisë është duket -- është e madhe -- në
23 krahasim me strukturat e tjera. Pra, keni punu në oborr me
24 armë, kur e keni bo këtë punë, nuk e keni dallu, nuk e keni pa
25 që në fund të oborrit ishte një ndërtesë e tillë? Nuk ka qenë

1 larg. Mund ta e keni parë këtë nga fotografia nga ajri. Po
2 përpiqem të kuptoj se si është e mundur që nuk e keni pa këtë
3 ndërtesë?
4 PË. Z. Prokuror, jam tuj e cek e katërta herë, e pesta jam
5 tuj e cek që kanë qenë tre apo katër kaminë kanë qenë të
6 prishtë. Ajo pjesë nuk është pa. Unë e kam pas detyrën time,
7 faktikisht, me kry punën time e jo me inspektu ndërtesa të
8 tjera, cila ndërtesë, ku e çka është. Nuk më ka ra në sy edhe
9 s'e ka pas vëmendjen te kjo ndërtesë. As te kjo as tek ajo. I
10 kam pas punët e mia. Për që atë arsye faktikisht se unë s'kam
11 mujt me u koncentru në çdo aspekt me këqyr me inspektu aty çka
12 ka, te ka.

13 Po them që unë të premtën për herë të parë e kam pa këtë
14 ndërtesë dhe jam çudit kur e kam pa në dosjen time. Në vitin
15 2000 kur më keni marrë në pyetje si Prokurori këtë fotografi
16 s'ma keni tregue. Nuk e kam pa. Prokurori e ka qit një [e
17 pakuptueshme] të dy pjesëve të uzinës, por këto faktikisht
18 njëfarë mënyrë kishin vizitu një ndërtesë. Ato ka qenë vetëm
19 vizatim, nuk ka qenë kjo fotografi.

20 PY. Z. Hoxha --

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Dëshmitar, nuk ka pse ta merrni keq për keq këtë, sepse
23 kurrkush nuk po ju thotë që ka qenë puna juje që me inspektu
24 vendin atëherë në atë kohë. Këtu e vetmja gjë që ne po
25 përpiqemi të kuptojmë është që nga ajo që ju kujtohet që keni

1 pa atëherë dhe Prokurori ka të drejtë me ju bë këto pyetje
2 lidhur me këto çështje. Ju lutem, përqendrohuni vetëm
3 përgjigjuni pyetjeve.

4 Z. Avokat.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë që po marr fjalën
6 shpesh.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
8 jeni, nuk po na bezdisni. Keni të drejtën.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Transkripti -- thuhet aty që jeni
10 tejet i inatosur. Znj. Gjykatëse, desha të them mos u, ndoshta
11 jeni pak të irrituar. Këtu ka dalë e shkrume se tejet i
12 zemëruar, i skandalizuar.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit, z. Prokuror -- z. Avokat.

15 Z. Prokuror e keni fjalën ju.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

17 PY. Desha të sqaroj çështjen e kamionëve, së pari. Në faqen
18 104 para pak minutash, rreshti 23, 24, thatë që aty ishin tre-
19 katër kamionë të prishur. Dhe që për shkak të kësaj një pjesë
20 e ndërtesës prapa saj -- prapa tyre nuk shihej. Këtë e keni
21 thënë edhe dje në faqen 44, rreshtat 7 deri 11.

22 Lidhur me këto kamionë kam disa pyetje. Së pari, këta
23 kamionë të prishur, a kanë qenë aty vazhdimisht aty gjatë
24 kohës që keni ndejt ju në Kukës?

25 PË. Po, vazhdimisht aty kanë qenë.

1 PY. Gjatë gjithë kësaj kohe askush s'u nuk u mor me ta për
2 t'i riparu, për t'i vu në lëvizje prapë?

3 PË. Po jo se me siguri kanë pas defekte të mëdhaja dhe nuk
4 kanë mujt me i riparu.

5 PY. Në intervistën tuaj me ZPS-në, me Prokurorin dhe e kemi
6 këtë në Pjesën 2, faqe 21 deri në faqen 23, juve janë bërë
7 pyetje të hollësishme dhe të gjëra lidhur me këtë kompleksin e
8 uzinës dhe në asnjë moment, gjatë intervistës, nuk keni
9 përmendur kamion të prishur. Dhe dua t'ju lexoj një pjesë të
10 asaj që keni thënë lidhur me këto. Në fakt është edhe një
11 pyetje aty lidhur me kamionët.

12 Pyetja e Prokurorit është, dhe e kemi këtu në rresh të 13
13 dhe 18, pra, pyetja e Prokurorit ishte:

14 "A keni parë ndonjëherë kamion në fund të kompleksit
15 aty?".

16 Përgjigje:

17 "Po ka patur kamion, ka patur shpesh kamionë që hynin e
18 dilnin. Pra, ata parkoheshin kudo në zonë aty".

19 Megjithatë, ju s'keni përmend aty në këtë intervistë
20 kamionë të prishur. Keni thënë që ka patur kamionë që hynin e
21 dilnin, kamionë që ishin të parkuar, por nuk keni, pse s'i
22 keni thënë Prokurorit atëherë që kanë qenë tre-katër, siç po
23 thoni, kamionë të prishur aty, që kanë qenë aty vazhdimisht
24 aty? Vetëm tani po e thoni këtë gjë, pse se keni thënë
25 atëherë?

1 PË. Po me siguri që nuk e kam thënë atëherë se këtë fotografi
2 faktikisht nuk ma kanë prezantuar atëherë Prokuroria. Kanë pyet
3 për atë objekt faktikisht, unë i kam tregu pse nuk është në
4 stenogram okej diçka tjetër, iu kam tregu që ka pas kamionë të
5 prishun. Se këtu është hapësira është e madhe. Faktikisht,
6 kanë hy edhe kanë dalë kamionë pandërpre. Kanë ardhë me
7 material, janë shkarku, kanë dalë. Janë ardhë, kanë marrë
8 material, kanë dalë menjëherë. Që këta kamionët e prish,
9 faktikisht, kanë nejt aty pandërpre, se kanë qenë me defekte
10 të mëdhaja. As kanë pas mekanik kush me i rregullu a çka ka
11 qenë arsyeja unë nuk e di. Nuk ka qenë ajo detyra e imja.

12 Unë para q'atyne kamionëve, faktikisht, i kam qit
13 tavolinat dhe q'aty kam punue. Për shembull, tash ku është
14 numri 3, q'aty, bash q'aty ku është numri 3, q'aty e kam qit
15 tavolinën, q'aty kam punue. Mbrapa 3-shit kanë qenë kamionët.
16 PY. Z. Hoxha, ky është problemi që kam unë. Pyetja ishte e
17 hapur: Ku ishin kamionët në atë kompleks, dhe në intervistën
18 që i keni dhënë ZPS-së nuk keni thënë që kanë qenë, ka pas
19 kamionë të prishur. Tri a katër kamionë, është një grup
20 kamionësh.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
22 që kam dy avokatë në të majtë të çuar në këmbë.

23 Dhe në fakt është edhe koha e pushimit. Megjithatë ---

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Të jemi të drejtë me dëshmitarin.
25 Ai po fliste për kamionët, kamionë të prishur pranë depos. Unë

1 nuk po e kuptoj pse kolegu i nderuar nga Prokuroria thotë që
2 nuk e ka përmendur këtë dëshmitari. Ai e ka thënë këtë tek
3 intervista 077857 --

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
5 kemi përpara, e kemi përpara.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në faqen 5. E kemi këtu, e kemi
7 këtu, pra, Pjesa 2 faqja 5.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
9 kemi këtu.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faqja 19 e në vijim.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
12 kemi, por ka një dallim ama, po nuk e them tani, por edhe ju
13 po e shihni këtë dallim se e shoh që pohoni me kokë.

14 Do të doja që të bënim një pushim tani, 10 minuta përveç
15 nëse mendoni që nuk është e përshtatshme se jeni në mes të
16 pyetjes. Mund t'ju lejoj të vazhdoni.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Më mirë bëjmë pushimin.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull.

20 Avokat keni fjalën.

21 Z. AOUIINI: [Përkthim] Faleminderit. Vetëm një referencë
22 për të hequr çdo paqartësi. Shohim faqen 25 të deklaratës që
23 është përmendur -- më falni, faqja 23, rreshtat 15 deri në 18.
24 Në fund të rreshtit 18 është një pjesë, nuk po hyj shumë në
25 detale, ju ftoj ju ta lexoni, është një pjesë aty që mund të -

1 - jetë shprehur kjo që po diskutojmë. Nuk po e lexoj.

2 Faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Bëjmë
4 një pushim dhjetë minuta dhe ju lutem, ktheheni brenda 10
5 minutëshit. Jo, pasi të kenë kaluar 10 minutat. Fillimisht të
6 ruajmë imazhin. A mund ta ruani imazhin në të djathtë të
7 ekranit tonë dhe t'i caktoni numrin e Zyrës Administrative.

8 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Seancës
9 këshillohen]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Përpara nëse e ruajmë nuk mund të bëjmë më shënime. Po kur
12 kemi pushim s'mund ta lemë në ekran. Kështu që, ju lutem, ta
13 ruani.

14 Dëshmitar, do bëjmë më pak se 10 minuta pushim. Dhe do
15 vazhdojmë dhe gjysmë ore dhe do përfundojmë për sot.

16 DËSHMITARI: Në rregull. Faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
18 shihemi për 10 minuta.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 shënimet që bëri dëshmitari 03887 në materialin SPOE00330362
22 marrin numrin REG00994.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull. Bëjmë 10 minuta pushim.

25 --- Pauza fillon në orën 15.38

1 --- Seanca rifillon në orën 15.49

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vërej
3 që përbërja e ekipeve është njësoj. E marr parasysh këtë gjë.

4 Përpara se të sjellim dëshmitarin desha, u ngrit një pikë
5 me të drejtë nga ana e majta. Me pamë disa ndryshime çfarë
6 ishte thënë në deklaratat e mëhershme dhe çfarë u tha në
7 sallën e gjyqit, i konstatuam këto ndryshime, por ua lë ju në
8 dorë. Por po ju udhëzoj që do të jemi të drejtë me dëshmitarin
9 dhe t'i tregonit edhe këtë pjesë të deklaratës së mëhershme.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
12 shoh në të majtë, në rregull.

13 Sillni dëshmitarin në sallë dhe vazhdojmë për 20 minuta
14 deri në 16.10.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
17 se u kthyet, Dëshmitar!

18 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta!

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Shala e dëgjuat përgjigjen e dëshmitarit?

21 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po e dëgjoj mirë,
22 faleminderit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
24 mirë.

25 Dëshmitar, do vazhdojmë e për 20 minuta me pyetjet për

1 sot dhe do rifillojmë nesër sërish.

2 DËSHMITARI: Në rregull.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjala
4 është për ju.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Z. Hoxha, para se të merrni pushimin, ju po na thonit se
7 gjatë intervistës me ZPS-në asnjëherë nuk jua kanë treguar atë
8 ndërtesën, ndërtesën e fundit që po diskutonim, këtë thatë?

9 PË. Po. Herën e parë e kam pa të premtën, faktikisht.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua t'i
11 tregoj dëshmitarit deklaratën që i ka dhënë ZPS-së që vërteton
12 se në të vërtetë i është treguar ndërtesa dhe ka komentuar në
13 lidhje me këtë.

14 Me lejen tuaj, të nderuar Gjykatës, do doja që në ekran
15 të shfaqej intervista e ZPS-së 077857-TR-ET Pjesa 2, faqja 22.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Sekretare, ju lutem, vendosni materialin në ekran.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faqja 22.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
20 dëshmitarin do këtë -- bëjmë me përkthimin në shqip, pra, do
21 ta bëjë, do ta bëjnë përkthyesit përkthimin.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po fiks, fiks kjo pjesa që kemi
23 përpara.

24 PY. Në rregull. Z. Hoxha, kjo është Pjesa 2 e intervistës që
25 ju keni dhënë me ZPS-së. Përpara në rreshtin 6 është një numër

1 aty ERN 074390. Pra, u kemi, ju kemi treguar një fotografi që
2 kishte këtë numrin ERN dhe ka qenë pikërisht ndërtesa e bardhë
3 për të cilën kemi biseduar, ndërtesa në fund të oborrit që e
4 kemi komentuar gjatë e gjerë. Ju vazhdoni tani të thoni që
5 hera e parë që keni parë fotografinë ka qenë të premtën? Ende
6 thoni këtë gjë tani?

7 PË. Po ende them. Faktikisht, atë ditë kur më keni marrë në
8 pyetje në Prishtinë më është treguar një fotografi ka qenë kaq
9 e gjatë. Kanë qenë objektet, fotografitë e objekteve në mes të
10 objektit, faktikisht, ka qenë një si makete, asgjë tjetër. Nuk
11 ka qenë kjo fotografi. Kjo identike nuk ka qenë asnjëherë.
12 Asnjëherë pa nuk e kam. Ka qenë e kapme me seilotep,
13 faktikisht anësh, në të dyja anët.

14 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë doja
16 t'i thoja dëshmitarit që në intervistën e ZPS-së ai ka
17 komentuar në lidhje me këtë. Në faqen 14 në gjuhën shqipe e
18 kemi saktësisht të njëjtën gjë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
20 nuk shoh kundërshtime nga Mbrojtja që të vendosim këtë
21 ekstrakt, këtë fragment.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Unë në fakt këtë sugjerim do jepja
23 të shikojmë audio a video çfarë kemi për t'u siguruar.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
25 keni mundësi t'i bëni raund tjetër pyetjesh nëse gjykoni është

1 e nevojshme ta eksploronim më tej këtë temë. Pra, unë thjesht
2 desha t'ju pyesja doni që të vendosni dhe versionin në gjuhën
3 shqipe. Po unë personalisht nuk e gjykoj të nevojshme.

4 Z. AOUIINI: [Përkthim] Nuk mendoj që është problem
5 përkthimi këtu shqipja dhe anglishtja. Po do donim t'ju
6 shikojmë atë version të intervistës ku është diskutuar kjo
7 gjë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 rregull, këtë e vendosni ju kur të bëni pyetjet tuaja. Por për
10 momentin nuk kemi përkthim në shqipe; nuk do vendosim
11 përkthimin në shqipe të këtij dokumenti.

12 Prokuror, vazhdoni.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

14 PY. Z. Hoxha, gjatë dëshmisë që dhatë dje që është në faqen
15 33, rreshtat 10 e 13 të transkriptit të ditës së djeshme, ju
16 dhatë dëshmi që përveçse punonit brenda depos, punonit edhe në
17 oborr edhe e përsëritet edhe sot këtë gjë, saktë?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Edhe ju shënuat edhe vendin ku punonit jashtë. Kur dilje
20 nga ndërtesa, kur dilje nga ndërtesa, nga depoja dhe punonit
21 në atë vendin që thatë. Ndërtesa për të cilën po flasim ne,
22 pra, ajo ndërtesa që ju nuk e njihni është thjesht majtas,
23 është direkt në të majtë të vendit ku riparohet ju armët
24 jashtë në oborr. Ky përshkrimi që sapo bëra unë, a ju ndihmon,
25 a ju rinfreskon kujtesën që ka qenë ajo ndërtesë atje? E keni

1 parë apo prapë nuk ju kujtohet asgjë në lidhje me të?

2 PË. Unë ju thashë e s'di sa herë ju thashë. Faktikisht prej
3 daljes, prej depos kryesore kur dilsh në anën e majtë aty kam
4 punu, aty kanë qenë kamionë. Më së pari kanë qenë të parkum,
5 para kamionëve faktikisht kam punë q'aty. Më ka ndodhur dy
6 herë apo tri herë kam punu aty, se përndryshe kam punu brenda
7 pa ndërpre. Po dy herë a tri më ka ndodh aty para kamionëve.
8 Kanë qenë kamionët kanë qenë të parkum, unë para kamionëve kam
9 punu.

10 PY. Z. Hoxha, a ka ndodhur, a ka rast, a keni, a ka ndodhë
11 ndonjëherë që të flinit jashtë në oborrin e uzinës mekanike të
12 Kukësit?

13 PË. Po më ka ndodhë një rast. Kam qenë aq i lodhun,
14 faktikisht, vetëm jemi hyp në një kamion, një rimorkio,
15 faktikisht, jam ra dhe q'aty kam flejt.

16 PY. E keni fjalën për ndonjë nga ato kamionët e prishur apo
17 ndonjë kamion tjetër?

18 PË. Kamionët, kamionët e prishur.

19 PY. Pra, ju po thoni që keni fjetur vetëm një herë në
20 rimorkion e atij kamioni, kështu, vetëm një herë?

21 PË. Një herë.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do doja
23 t'i tregoja dëshmitarit deklaratën që i ka dhënë ZPS-së në
24 lidhje me këtë temë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

3 PY. Z. Hoxha, në Pjesën 2 të deklaratës për ZPS-në 077857-TR-
4 ET, në faqen 5 ju keni thënë se ka pasur raste që keni fjetur
5 atje.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
7 falni z. Prokuror, do doja që të shfaqej në ekran.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në rregull. E vendosim në
9 ekran. Është materiali me numër 077857-TR-ET Pjesa 2, faqja 5.

10 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

12 PY. Pyetja ishe, mund t'i hidhni dhe një sy. Fillon pyetja te
13 rreshti 4. Pyetja që ju ka bërë Prokurori:

14 "Më falni, unë po ju pyesja a keni fjetur, a ju është
15 dashur të flini ndonjëherë në këtë ndërtesë, por jashtë nën
16 yje".

17 Dhe ju jeni përgjigjur:

18 "Po, ka pasur raste ku nuk kishte vend tjetër ku të
19 qëndroje dhe të flije, as në këmbë s'mund të rrije. Kështu që
20 unë gjeta një vend jashtë edhe flija edhe atje. Kishte raste
21 në shumës, pra".

22 Pra, në intervistën që i keni dhënë ZPS-së jeni referuar
23 në shumës, raste. Jo një herë. Pra, cila është dëshmia juaj? A
24 keni fjetur nën qiell të hapur në oborrin, në oborr vetëm një
25 herë apo disa herë siç keni thënë në intervistën me

1 Prokurorinë?

2 PË. Si është shkruajt intervista nuk e di, por unë kam flejt
3 vetëm një herë më ka ndodh; një herë më ka ndodh. Kam qenë
4 tepër i lodhur, faktikisht, edhe jam ra aty, kam pushue.

5 PY. Z. Hoxha, gjatë qëndrimit në uzinën mekanike të Kukësit,
6 a ju ka ndodhur të merrnit pjesë në stërviçet fizike që
7 organizoheshin në oborrin e uzinës, në përgatitjen fizike?

8 PË. Jo, zakonisht unë s'kam dalë.

9 PY. Zakonisht nuk dilnit. Po a ka rastisur ndonjëherë që të
10 keni marrë pjesë në këtë përgatitje fizike?

11 PË. S'më kujtohet a kam dalë ndonjëherë apo jo, por 99 për
12 qind të raste, jo.

13 PY. A keni marrë pjesë në këto stërviçje sikur të paktën një
14 herë?

15 PË. Nuk e di; s'më kujtohet. Janë 24 vjet janë në pyetje.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund t'i
17 tregoj dëshmitarit intervistën e vet që i ka dhënë Prokurorisë
18 lidhur me këtë aspekt?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
20 mundeni. Keni dhe 5 minuta përpara se të përfundojmë seancën
21 për sot. Kështu që besoj se do të jetë dhe pyetja e fundit.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Patjetër.

23 A mund të vendosim dokumentin 077857-TR-ET Pjesa 1 RED2,
24 faqja 22.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Vazhdoni, Sekretare.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Fillojmë në rreshtin 6 deri në
3 rreshtin 22 mbase.

4 PY. Pyetja është për ushtrimet. Ai thotë:

5 "Ju përmendët ushtrimet e mëngjesit brenda kompleksit të
6 uzinës mekanike. Na thoni çfarë ju kujtohet? A ishte për të
7 gjithë?".

8 Ju jeni përgjigjur:

9 "Jo, jo. Nuk ishte, as unë nuk shkoja gjithmonë atje, çdo
10 herë. Ndonjëherë përtoja, isha i lidhur, nuk ishte ushtrim me
11 detyrim. Personat shkonin nëse dëshironin dhe nuk shkonin nëse
12 ishin të lodhur dhe kishin nevojë për pushim".

13 Në rreshtin 20 Prokurori ju bën një pyetje:

14 "Ishte jashtë, jo nën një çati?".

15 Ju jeni përgjigjur:

16 "Po, ishte në zonë të hapur dhe koha ishte e mirë. Ishte
17 maj, qershor në atë kohë".

18 Nga ky fragment i shkurtër që ju lexova, ju keni thënë në
19 këtë fragment që nuk shkonit çdo herë, por ndonjëherë, sepse
20 ndonjëherë përtonit. Dhe në këtë ditë nuk merrnit pjesë në
21 ushtrime. Por siç e kuptoj unë, mund të më korrigjoni, siç e
22 kam kuptuar unë këtë pjesë, kjo tregon që ndonjëherë ju merrni
23 në ushtrimet fizike në oborrin e uzinës, a s'është e vërtetë?

24 PË. Po mundet me ndodhë që kam dalë ndonjë ditë apo, por

25 shumicën e kohës nuk kam dalë; shumicën e kohës nuk kam dalë

1 se kam pas obligime tepër të mëdhaja gjatë ditës, faktikisht,
2 kam qenë, pandërpre kam qenë i lodhur. Mundet me ndodhë që kam
3 dalë ndonjë ditë, por shumicën e rasteve jo. Nuk ka qenë e
4 obligume. E përndryshe aty kanë dalë me ushtru ushtarët që
5 kanë qenë gjenerata më të reja. Unë në atë kohë, faktikisht, i
6 kam pas 38 vjeç i kam pas.

7 PY. A ju kujtohet në cilën pjesë të oborrit bëheshin këto
8 ushtrimet fizike?

9 PË. Është pjesa qendrore, faktikisht, para Shtabit q'aty.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të
11 përfundoj për momentin dhe me lejen tuaj do doja të rifilloja
12 nesër në mëngjes.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit, Prokuror.

15 Në rregull. Dëshmitar, ka qenë ditë e gjatë. Do të
16 rifillojmë sërish nesër me dëshminë tuaj. Pushoni sot edhe do
17 të shihemi sërish bashkë në orën 09.30. Faleminderit për
18 përpjekjet tuaja dhe ju kujtoj dhe një herë që nuk duhet të
19 diskutoni asnjë aspekt të dëshmisë tuaj me asnjë person. E
20 kuptoni këtë?

21 DËSHMITARI: Po, në rregull, shumë faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Shihemi nesër.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Prokuror, sa kohë mendoni se ju nevojitet për nesër?

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Besoj se gjysmë ore.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Mbrojtësi i Viktimave, ju keni pyetje për dëshmitarin?

5 Z. LAWS: [Përkthim] Më vjen keq, nuk ju dëgjova.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

7 mund të na thoni tani nëse synoni t'i bëni pyetje dëshmitarit

8 e nëse po sa kohë mendoni se do ju nevojiten?

9 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk besoj se kam pyetje.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Avokat, e di që është herët, se do ketë edhe gjysmë ore

12 Prokuroria nesër, por a synoni të keni një raund pyetjesh

13 shtesë?

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mbase një ose dy pyetje

15 maksimumi.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ju

17 pyes, sepse duhet të planifikojmë për dëshmitarin e radhës që

18 të llogarisim çfarë kohe do të sjellim dëshmitarin tjetër.

19 Në rregull atëherë.

20 Pyetja e fundit, a ka ndonjë gjë që palët edhe Mbrojtësi

21 i Viktimave duan të parashtrojnë? Jo, atëherë.

22 Ju uroj pasdite të këndshme. Shihemi nesër në sallën e

23 gjyqit në orën 09.30.

24 Seanca mbyllet këtu.

25 --- Seanca mbyllet në orën 16.11